

KONTRATE KONÇESIONI

PËR

DHËNIEN ME KONCESION TË SHËRBIMIT TË KONTROLLIT TEKNIK TË
DETYRUESHËM TË MJETEVE RRUGORE ME MOTOR DHE RIMORKIOVE TË TYRE
NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

Tiranë, më 03.09.2009

KJO KONTRATE KONÇESIONI në lidhje me financimin, ndërtimin, pronësinë, shfrytëzimin, mirëmbajtjen dhe transferimin e shërbimit të kontrollit teknik të detyrueshëm të mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove të tyre në Republikën e Shqipërisë ("Kontrata"), lidhet sot në datë 03.09.2009, ndërmjet:

(1) **MINISTRISË SË PUNËVE PUBLIKE, TRANSPORTIT DHE TELEKOMUNIKACIONIT** të Republikës së Shqipërisë, që vepron në përputhje me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 27, datë 19.01.2007 "Mbi Miratimin e Rregullave për Vlerësimin dhe Dhënie të Koncesioneve" dhe Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 643, datë 03.10.2007, "Mbi përcaktimin e Autoritetit Kontraktues për Dhënie të Koncesion të shërbimit të kontrollit teknik të detyrueshëm të mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove të tyre në Republikën e Shqipërisë" ("MPPTT" ose "Autoriteti Kontraktues"); dhe

(2) **SOCIÉTÉ GÉNÉRALE DE SURVEILLANCE SA**, një shoqëri anonime e krijuar sipas ligjeve të Konfederatës Helvetike e regjistruar në Regjistrin Tregtar të Gjenezës me datë 2 korrik 1975, me nr. Reference 04198/1975, me nr. Federal CH-660-0172975-8, me seli në 1 Place des Alpes, CH - 1211, Geneva, 1, ("SGS" ose "Konçesionari").

Secili prej tyre, si Autoriteti Kontraktues dhe Konçesionari, do të referohen individualisht si "Pala" dhe bashkërisht si "Palët".

PARATHENIE

Kushte Paraprake:

(A) Në përputhje me sa vijon:

- Ligjin nr. 9663, datë 18 Dhjetor 2006 "Për Konçesionet" (i ndryshuar),

- Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 27, datë 19 Janar 2007 "Mbi miratimin e kritereve të vlerësimit në lidhje me dhënie të koncesioneve" (i ndryshuar);

- Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 643, datë 03.10.2007, "Mbi përcaktimin e Autoritetit Kontraktues për Dhënie të Koncesion të shërbimit të kontrollit teknik të detyrueshëm të mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove të tyre në Republikën e Shqipërisë"

- Ligjit nr. 8378 dt. 22.07.1998 "Kodi Rrugor i R.SH-se", i ndryshuar;

- Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 153 dt. 07.04.2000 "Rregullore e zbatimit të Kodit Rrugor të R.SH-se" (i ndryshuar);

- Manuali dhe Rregullorja "Mbi Kontrollin Teknik te Mjeteve Rrugore" Ministrit te Puneve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, i ndryshuar;
- Direktives se BE-se 96/96/EC te 20 Dhjetor 2006 "Mbi perafrimin legjislacionit te Shteteve Anetare ne lidhje me pershtatshmerine ndaj qarkullimit te mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove te tyre", i ndryshuar;
- Direktiva e KEE-se, 92/54/CEE e 10 Gusht 1992 "Kontrolli Teknik i Mjeteve me motor dhe rimorkiove te tyre (shkarkimi i gazrave) i ndryshuar";
- Kodi Civil i R.SH-se 1994, i ndryshuar;
- Ligj nr.7764, date 2.11.1993 "Per Investimet e Huaja";
- Ligj nr.7515, dt.1.10.1991 "Per anetaresine e R.SH-se ne Fondin Monet Nderkombetar, Banken Nderkombetare per Rindertim dhe Zhvillim, Korporate Financiare Nderkombetare, Shoqaten e Zhvillimit Nderkombetar, Agjensine Garantimit te Investimeve Shumepaleshe dhe ne Qendren Nderkombetare per Zgjidhjen e Konflikteve te Investimeve (ICSID)";
- Marreveshje dt. 22.09.1992, ndermjet Qeverise se R.SH-se dhe Keshillit Feder Zviceran "Per nxitjen dhe mbrojtjen e ndersjellte te Investimeve";
- Konventa e ICSID, hyre ne fuqi ne dt.14 Tetor 1966;
- Kerkesen per Propozim dhe Udhезimet per Ofertuesit, (Dokumentat Standarte te Tenderit), MPPTT ka ftuar ofertuesit te paraqesin ofertat e tyre per financimin ndertimit, pronesine, shfrytezimin, mirembajtjen dhe transferimin e sherbimit te kontrollit teknik te detyrueshem te mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove te tyre ne Republikene e Shqipërisë;
- Cdo Ligj tjeter.

Autoriteti Kontraktues eshte i autorizuar qe te nenshkruaje kete kontrate.

- (B) Me dt.18.12.2008, ora 12:00, Koncesionari SGS ka paraqitur propozimin e tij ne lidhje me kete procedure konkurruese ("Oferta e Koncesionarit"), i cili eshte pranuar nga Autoriteti Kontraktues;
- (C) Me dt.12.05.2009, Autoriteti Kontraktues i ka derguar Koncesionarit "Njoftimin e Renditjes", (Dokumenti nr. 3201 prot.), ndersa me date 22.05.2009, nepermjet shkreses me nr. Prot. 3201/6, "Njoftim Fituesi", Autoriteti Kontraktues njoftoi Koncesionarin per pranimin e ofertes se paraqitur nga ky i fundit;
- (D) Negociatat per negociimin e kushteve te Kontrates u hapen zyrtarisht ne date 17 qershor 2009;
- (E) Kjo Kontrate Koncesioni do te hyje ne fuqi ne daten e nenshkrimit te saj nga te dyja Palet ("Data Efektive");
- (F) Autoriteti Kontraktues dhe Koncesionari angazhohen ne baze te kesaj Kontrate me qellim per te vene ne zbatim Koncesionin, sipas afateve dhe kushteve te parashikuara ne vijim;
- (G) Koncesionari, brenda 2 (dy) javeve nga Data Efektive e kesaj Kontrate do

te themeloje nje shoqeri tregtare (ne vazhdim "Shoqeria Koncesionare"), te ciles do t'i transferohen te gjitha te drejtat dhe detyrimet e Koncesionarit sipas kesaj Kontrate.

Per kete arsye, duke marre parasysh detyrimet e parashikuara ne kete dokument, te cilat jane pranuar mes Paleve, Palet bien dakord si me poshte vijon:

1. PËRKUFIZIMET DHE INTERPRETIMET

1.1 Përkufizimet

Kurdoherë që fjalët me gërmën e parë të madhe do të përdoren në këtë Kontrate (duke përfshirë edhe Anekset e saj), këto fjalë do të kenë kuptimet e mëposhtme:

"Kontratë Konçesioni" ose **"Kontratë"** do të thotë kjo Kontratë Konçesioni (dhe të gjitha Anekset e saj, të cilat do të konsiderohen pjesë përbërëse e pandashme e saj) dhe dokumentat bashkëngjitur kësaj Kontrate ose Anekseve të saj, pavarësisht emrit që i jepet në vijim të negociatave mes Autoritetit Kontraktues dhe Konçesionarit.

"Aneks" do të thotë çdo shtojcë e kësaj Kontrate që formon një pjesë integrale dhe të pandarë të saj.

"Të Drejta Koncesionare" do të thotë të drejtat e Konçesionarit duke filluar nga Data Efektive, siç parashikohet në Nenin 18.1 (Të drejtat Koncesionare).

"Gëzim i qetë" do të thotë e drejta ekskluzive për të zënë, përdorur dhe gëzuar trojet dhe objektet mbi to të QKT Ekzistuese dhe të Drejtën për Kalim gjatë Periudhes Koncesionare (nëse do të jetë rasti), në përputhje me këtë Kontratë, pa ndërhyrje të parregullt dhe abuzive nga Autoriteti Kontraktues ose nga ndonjë Entitet Shtetëror.

"E Drejta për Kalim" do të thotë e drejta për të kaluar mbi dhe nën Shesh dhe në çdo pjese të tyre, si dhe për të hyrë dhe për të dalë në to, pa ndërhyrje të parregullt nga ndonjë palë e tretë me qëllimin e zbatimit të kësaj Kontrate.

"Konçesionar" do të thotë "Société Générale de Surveillance SA" ose shkurt "SGS".

"Shoqëri Koncesionare" do të thotë një shoqëri që do të themelohet dhe funksionojë sipas ligjeve të Republikës së Shqipërisë dhe që do t'i përmbahet parashikimeve të Nenit 9.

"Autoritet Kontraktues" do të thotë "Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit e Republikës së Shqipërisë" ose shkurt "MPPTT".

"Përfaqësuesi i Autoritetit Kontraktues" do të thotë çdo përfaqësues që mund të caktohet herë pas here nga Autoriteti Kontraktues për ta përfaqësuar në lidhje me



kryerjen e ndonjë prej të drejtave të tij sipas kësaj Kontrate, me kusht që, nëse do të lindë në vijim nevoja, Autoriteti Kontraktues të njoftojë menjëherë Konçesionarin për çdo mbarim mandati, zëvendësim ose ndërrim përfaqësuesi.

“Oferta e Konçesionarit” ka kuptimin e parashikuar në Pikën (B) të Kushteve Paraprake të kësaj Kontrate.

“Data e Paraqitjes së Ofertës” do të thotë data 18.12.2008, ora 12:00, në të cilën ofertuesit kanë paraqitur ofertat e tyre për këtë konçesion në përputhje me Udhëzimet për Ofertuesit.

“Çmimi i Ofertës” ka kuptimin siç përcaktohet në Oferten e Konçesionarit.

“Data Efektive” ka kuptimin e përcaktuar në Pikën (E) të Kushteve Paraprake dhe Nenin 4/1 të kësaj Kontrate.

“Plan Projekt” do të thotë plani i veprimit sipas Aneksit VII me qëllim realizimin e këtij Konçesioni nga Konçesionari.

“Faza Para Ndërtimore” do të thotë faza sipas përcaktimeve të Nenit 18.3.

“Punime Ndërtimi”, do të thotë të gjitha punimet që nevojiten për ndërtimin e QKT se Re si dhe të gjitha punimet rehabilituese dhe ndihmese për modernizimin e QKT Ekzistuese, duke përfshirë të gjitha punimet e domosdoshme civilo-inxhinierike të çdo natyre (përfshirë ato të instalimit dhe testimit të Pajisjeve Elektromekanike dhe Kompjuterike) me qëllim bërjen funksionale të të gjitha QKT Ekzistuese, QKT së Re dhe QKTL.

“Faza e Ndërtimit” do të thotë periudha e kohës që rrjedh nga Data Efektive deri në Datën e Përfundimit të Punimeve të Ndërtimit përfshirë këtu instalimin e Pajisjeve Elektromekanike dhe Kompjuterike dhe testimin e tyre sipas Aneksit IV (“Testimi”), gjatë së cilës Konçesionari do të ndërtojë dhe përfundojë Punimet e Ndërtimit në përputhje me afatet e kësaj Kontrate dhe instalimet përkatëse si dhe kohën që rrjedh deri në korrigjimin e ndonjë defekti të mundshëm në Punimet e Ndërtimit. Për QKT e Re është periudha 6 (gjashtë) muaj. Për QKTL do të jetë periudha 5 (pese) muaj.

“Grafiku i Punimeve” do të thotë grafiku i punimeve të ndërtimit sipas Aneksit VIII të kësaj Kontrate përfshirë këtu ndreqjet për të meta apo për vonesa.

“Data e Përfundimit të Punimeve të Ndërtimit” do të thotë data e përfundimit të plotë të punimeve të ndërtimit sipas Grafikut të Punimeve, përfshirë periudhën eventuale për ndreqjen e të metave apo zgjatjen e Fazës Ndërtimore nga Autoriteti Kontraktues sipas Nenit 18.4.5.



“Njoftimi i Përfundimit të Fazës Ndërtimore” do të thotë njoftimi i përfundimit të plotë të fazës ndërtimore (i cili nenkupton dorezimin e dokumentacionit sipas akteve ligjore për disiplinimin e punimeve të ndërtimit) dhe instalimit e vënies në funksionim dhe testimit të Pajisjeve Elektromekanike dhe Kompjuterike (përfshirë këtu periudhën e nevojshme për riparimin e ndonjë defekti në Punimet e Ndërtimit) dhe vënia në funksion të plotë të QKT Ekzistuese dhe QKT së Re për të ofruar Shërbimin sipas kësaj Kontrate,

“Periudha e Shfrytëzimit dhe Mirëmbajtjes” do të thotë periudha e kohës që zgjat nga Data e Përfundimit të Punimeve të Ndërtimit deri në mbarimin të Periudhës Konçesionare gjatë së cilës çdo QKT Ekzistuese do të jenë funksionale për të ofruar Shërbimin, përjashtuar Fazën e Ndërtimit për çdo QKT Ekzistuese.

“Punime Mirëmbajtjeje” do të thotë detyrimi i Konçesionarit, sipas kësaj Kontrate, për të kryer punime të tilla që janë të nevojshme për të siguruar mirëmbajtjen dhe funksionimin e duhur të QKT Ekzistuese, QKT së Re, QKTL dhe Pajisjeve Elektromekanike dhe Kompjuterike.

“Leje, Autorizim, Liçensë” do të thotë çdo miratim, leje, liçensë, autorizim, aprovim ose çertifikatë, nxjerrja ose ripërtëritja e secilës është në përgjegjësinë e çdo Entiteti Shtetëror dhe që kërkohet për zbatimin e kësaj Kontrate.

“Projekt-Ide” do të thotë projekt-ideja e përgatitur nga Konçesionari dhe e paraqitur si pjesë përbërëse e seksionit teknik të Ofertës së Konçesionarit, e cila përfshin vizatimet, raportet, dokumentat, programet, përlogaritjet lidhur me ndërtimet që do të kryhen sipas kësaj Kontrate.

“Projekt-Zbatimi” do të thotë projekti i detajuar përse i përket QKT së Re dhe QKT Ekzistuese që është mjaftueshëm i detajuar për realizimin e ndërtimit/eve për të cilat është përgatitur.

“Tarifë Konçesionare” është tarifa që Konçesionari i paguan Autoritetit Kontraktues për përdorimin e konçesionit të dhënë sipas përcaktimeve të Nenit 8.1.

“Tarifë Kontrolli” do të thotë tarifa (me TVSH) që paguhet për kontrollin teknik të detyrueshëm (vjeter dhe periodik për ato mjete që aplikohet) të çdo mjeti me motor apo rimorkioje të tyre sipas tabelës A dhe/ose B të Aneksit VI bashkëngjitur kësaj Kontrate.

“Tarifë Rikontroli” do të thotë tarifa (me TVSH) që paguhet për rikontrollin teknik të detyrueshëm (vjeter dhe periodik, për ato mjete që aplikohet) të çdo mjeti me motor apo rimorkioje të tij sipas Nenit 8.3.

“Vlera e Investimit” do të thotë shuma totale (në Lekë) për kryerjen e investimit të nevojshëm për realizimin e Shërbimit siç përcaktohet në Nenin 8.4.

“Vlera e Riinvestimit” do të jetë shuma totale (në Lekë) që do të riinvestohet për

100
200

REPUBLICA
SHQIPTARE
MINISTRIA E
TRANSPORTIT
DHE
KOMUNIKIMIT

mirembajtjen/zevendesimin e makinerive, pajisjeve dhe sistemit kompjuterik te QKT-ve duke filluar nga viti i tete i Periudhes Koncesionare siç parashikohet në Nenin 8.5, duke pasur parasysh vlerën normale të amortizimit në kohë të këtyre pajiseve.

"Xhiro Vjetore" do të thotë të ardhurat (xhiro) bruto vjetore që grumbullohen nga Tarifat e Kontrollit dhe Rikontrollit që mbledhet nga Koncesionari në përputhje me legjislacionin në fuqi gjatë ofrimit të Shërbimit (vjetor dhe periodik për ato mjete që aplikohet) para pagesës së taksave në përputhje me legjislacionin shqiptar, e cila do të shërbejë si bazë për llogaritjen e Tarifës Koncesionare.

"Pajisje Ekzistuese" do të thotë pajisjet elektromekanike dhe/ose kompjuterike që janë gjendje pranë QKT Ekzistuese dhe do t'i dorëzohen Koncesionarit nga Autoriteti Kontraktues për t'iu kthyer më pas kur të instalohen Pajisjet Elektromekanike dhe Kompjuterike te reja.

"Pajisje Elektromekanike dhe Kompjuterike" do të thotë të gjitha pajisjet elektromekanike dhe kompjuterike (përfshirë këtu të gjitha pajisjet apo sistemet ndërlidhëse) që do të instalohen pranë QKT Ekzistuese dhe QKT së Re me qëllim ofrimin, mirëfunksionimin dhe mbarëvajtjen e Shërbimit të Kontrollit Teknik të detyrueshëm të Mjeteve Rrugore me Motor dhe Rimorkiove të tyre.

"QKT Ekzistuese" do të thotë sipërfaqet e trojeve dhe/ose ndërtimet mbi to në të cilat aktualisht Qendrat e Kontrollit Teknik kryejnë shërbimin e kontrollit teknik të detyrueshëm të mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove te tyre dhe te cilat jane percaktuar per t'u vene ne dispozicion te Koncesionarit sipas Aneksit I.

"QKT e Re" do të thotë sipërfaqja e truallit dhe ndërtimet mbi të në të cilën do të kryejë shërbimin e kontrollit teknik të detyrueshëm të mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove te tyre një Qendër e re Kontrolli Teknik që do të ngrihet sipas kushteve të kësaj Kontrate.

"Shesh" do të thotë tërësia e sipërfaqes së trojeve bashkë me ndërtesat mbi to QKT Ekzistuese si dhe trualli bashkë me ndërtesat mbi të e QKT së Re, përcaktuar në Aneksit I dhe II.

"QKTL" do të thotë qendër kontrolli teknik e lëvizshme (tre QKTL sipas ofertes se Koncesionarit).

"Rasti i Mospërmbushjes nga Autoriteti Kontraktues" do të thotë rastet e mospërmbushjes të përcaktuara në Nenin 23.1.2.

"Rasti i Mospërmbushjes nga Koncesionari" do të thotë rastet e mospërmbushjes të përcaktuara në Nenin 23.1.1.

"Aktet Korruprive" do të thotë akti i premtimit, i dhënies, i marrjes ose i marrëveshjes për të marrë para ose ndonjë send tjetër me vlerë, me qëllim korruptimi ose që perceptohet si korrupsim, për të ndikuar tek një punonjës publik në kryerjen e detyrave të tij shtetërore si dhe aktet që sjellin përgjegjësi penale sipas Kodit Penal Shqiptar.

"Mbyllje Financiare" do të thotë data kur nënshkruhen Dokumentet Financuese që mbulojnë koston totale kapitale të investimit për Konçesionin dhe ato hyjnë tërësisht në fuqi.

"Dokumente Financuese" do të thotë çdo marrëveshje huaje, bono, kontrata, instrumente, marrëveshje sigurimi, deklarata regjistrimi ose informimi, marrëveshje varësie, hipoteka, akte përfaqësimi e administrimi, marrëveshje kredie, marrëveshje për blerje bonosh, marrëveshje pjesëmarrjeje dhe dokumente të tjera që lidhen nga Konçesionari dhe/ose Shoqëria Konçesionare në lidhje me objektin e Konçesionit dhe për ushtrimin e të Drejtave Konçesionare, duke përfshirë modifikimet, plotësimet, shtesat, zgjatjet, ripërtëritjet dhe zëvendësimet e çdo financimi të tillë.

"Praktikë e Industrisë së Mirë" do të thotë praktikat, metodat, standardet, procedurat dhe rekomandimet që janë në përputhje me Ligjet e zbatuara përgjithësisht në shërbimin e kontrollit periodik të detyrueshëm të mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove të tyre përpara i përket dhënies me konçesion të këtij shërbimi, konçesion i cili pritet në mënyrë të arsyeshme të realizohet nga një kontraktor i aftë dhe me eksperiencë në rrethana të njëjta ose të ngjashme me praktika, metoda, standarde dhe procedura të cilat do të përfshijnë, pa kufizim, standardet Shqiptare dhe Evropiane (cilado qofshin më të larta, nga një periudhë kohore në tjetrën). Pa u kufizuar në to, në implementimin apo zbatimin e këtyre standarteve do të përfshihen aktet ligjore e nënligjore Shqiptare dhe Evropiane si në implementimin apo zbatimin e këtyre standarteve do të përfshihen aktet ligjore e nënligjore Shqiptare dhe Evropiane.

"Forcë Madhore" ka kuptimin e përcaktuar në Nenin 19 ("Forca Madhore").

"Entitet Shtetëror" do të thotë (i) Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, dhe/ose çdo ministri, departament ose nënndarje politike dhe administrative e saj; dhe (ii) çdo gjykatë ose instancë gjyqësore ose çdo entitet tjetër qeveritar, agjenci ose autoritet nën kontrollin e Republikës së Shqipërisë, ose çdo ministri, departament ose nënndarje politike e saj, si dhe çdo komunë ose bashki, dhe që ushtrojnë juridiksion sipas Ligjeve të Republikës së Shqipërisë mbi Konçesionarin, ose çdo autoritet i pavarur rregullator, në territorin e Republikës së Shqipërisë. Autoriteti Kontraktues përjashtohet nga ky përkufizim.

"Ligj" do të thotë çdo akt ligjor e nënligjor duke përfshirë edhe legjisllacionin ndërkombëtar me fuqi detyruese në Republikën e Shqipërisë, që kanë juridiksion mbi çështjen në fjalë që rregullon apo ndikon drejtpërsëdrejti apo tërthorazi në shërbimin e kontrollit teknik të detyrueshëm të mjeteve me motor dhe rimorkio.



“Kërkesat Teknike të Projektimit” do të thotë kërkesat teknike të projektimit në përputhje me legjislacionin për urbanistikën (Kërkesat Teknike të Projektimit);

“Kërkesat Teknike të Ndërtimit” do të thotë kërkesat teknike të ndërtimit në përputhje me legjislacionin për urbanistikën (Kërkesat Teknike të Ndërtimit);

“Taksë” do të thotë çdo taksë, detyrim, tatim, tarifë, pagesë, taksë doganore ose tarifë e çdo lloji, e ngarkuar, e vënë, e vendosur, e kërkuar, ose mbledhur, drejtpërdrejt ose tërthorazi, nga çdo Entitet Shtetëror sipas Ligjit, duke përfshirë çdo taksë malli dhe shërbimi, taksë shitjeje, tarifë pullash a vulash, tarifë importi, taksë mbi të ardhurat (qoftë mbi të ardhurat, dividendët, pagesat e interesit, tarifat, mbi qiratë e pajisjeve ose të tjera), taksë mbi huatë në monedhë të huaj ose transaksione këmbimi me jashtë, akcizë, taksë mbi pronësinë, tarifë regjistrimi ose liçence, duke përfshirë çdo interes, sanksion ose shtesa të tjera mbi to.

“Periudhë Konçesionare” do të thotë kohëzgjatja prej 10 (dhjetë) vjetësh duke filluar nga Data Efektive, përveç kur Kontrata zgjidhet më parë ose zgjatet në përputhje me kushtet e kësaj Kontrate, gjatë së cilës Palët e Kontratës do të jenë të lidhur në marrëdhënie kontraktore me qëllim përmbushjen e objektit të Konçesionit.

“Njoftimi për Zgjidhje” në lidhje me Autoritetin Kontraktues ose Konçesionarin, sipas rastit, do të thotë një njoftim i njëjës Palë drejtuar Palës tjetër që deklaron se kjo Kontratë do të zgjidhet, sipas rastit, në vijim: (i) të një Rasti Mospërmbushjeje nga Konçesionari ose të një Rasti Mospërmbushjeje nga Autoriteti Kontraktues, i cili nuk është përmbushur brenda kuadrit kohor të parashikuar në këtë Kontratë, (ii) të Forcës Madhore që zgjat mbi 6 (gjashtë) muaj, ose (iii) të çdo rasti tjetër të parashikuar shprehimisht në këtë Kontratë, i cili do të specifikojë shkakun e zgjidhjes dhe datën e zgjidhjes faktike të kësaj Kontrate, e cila do të jetë jo më parë se tridhjetë (30) ditë pas këtij njoftimi.

“Ditë Pune” do të thotë një ditë gjatë së cilës në Republikën e Shqipërisë punohet me përjashtim të të dielave dhe festave zyrtare.

“Orari i Punës” do të thotë orari i punës i QKT Ekzistuese dhe QKT të Re sipas përcaktimeve të nenit 18.2.5 më poshtë.

“Normë Inflacioni” do të thotë norma zyrtare e inflacionit sipas përlogaritjeve të INSTAT-it.

“Shërbim i Kontrollit Teknik të Detyrueshëm të Mjeteve Rrugore me Motor dhe Rimorkiove të tyre” ose **“Shërbimi”** do të thotë shërbimi ekzkluziv që do të ofrojë Konçesionari në përputhje me këtë Kontratë, duke përjashtuar çertifikimet dhe kontrollet për mjetet shtetërore që në përputhje me praktikat qeveritare në fuqi në datën e nënshkrimit të kësaj Kontrate i nënshtrohen kontrollit nga Ministria e Brendshme dhe Ministria e Mbrojtjes.

MINISTRI
PËR
TRANSPORTIN
DHE
INFRASHTRUKTURËN

"Manuali i Kontrollit të Mjeteve" do të thotë manuali shqiptar i normave teknike dhe të kontrollit teknik për të gjitha kategoritë e mjeteve, i cili përshkruan objektet, kufizimet dhe teknologjinë e kontrollit, kategorizon mospërputhjet e rrezikshme, të mëdha apo të vogla të objekteve të kontrollit si dhe përbën dokumentin kryesor për kryerjen e procedurës të kontrollit dhe informimin, përgatitjen dhe testimin e inspektorëve të kontrollit, i cili do të miratohet nga Ministri i MPPTT në përputhje me këtë Kontratë.

"Sigurimi i Kontratës" do të thotë një sigurim i rradhës së parë lëshuar nga një institucion bankar apo shoqëri sigurimesh që vepron në Shqipëri në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe që siguron përmbushjen e detyrimeve të Konçesionarit, duke pasur parasysh edhe Nenin 24 Sigurimi i Kontratës.

"Klient" do të thotë personi që paraqitet me një mjet me motor dhe/ose rimorkio për kryerjen e Shërbimit të Kontrollit të Detyrueshëm Teknik të Mjeteve Rrugore me Motor dhe Rimorkiove të tyre pavarësisht nëse është pronari i një mjete të tillë apo jo.

1.2 Interpretimi

Përveç kur nuk kërkohet ndryshe në këtë Kontratë:

- 1.2.1 Njejesi përfshin shumetin dhe anasjelltas;
- 1.2.2 Referimi tek njera gjini përfshin edhe gjinine tjetër dhe gjinine asnjane;
- 1.2.3 Referimi tek një ligj, vendim, rregullore, urdher apo procedurë përfshin referimin tek ai ligj, vendim, rregullore, urdher apo procedurë siç është ndryshuar, shtuar apo rimiruar kohë pas kohe dhe tek çdo akt tjetër si rrjedhim i tyre. Pasoja dhe efektet e çfarëdo ndryshimi, shtese apo rimirimi të tillë mbi këtë Kontratë do të zgjidhet në përputhje me nenin 27 Ndryshimet e Kontratës;
- 1.2.4 Termat "të kësaj", "këtu", "nëpërmjet kësaj ose nga kjo", "në këtë" dhe fjalë të ngjashme i referohen Kontratës në tërësi dhe jo ndonjë Neni, Paragrafi, Tabele, Bashkëlidhje ose Grafiku apo ndonjë nënndarje tjetër të kësaj Kontratë;
- 1.2.5 Parathenia dhe Shtojcat, Tabelat dhe Bashkëlidhjet të kësaj Marrëveshjeje do të përbëjnë pjesë integrale të kësaj Marrëveshjeje dhe referencat në Shtojcat, Tabelat dhe Bashkëlidhjet do të jenë referenca në Shtojcat, Tabelat dhe Bashkëlidhjet e kësaj Kontratë, përveç kur Palët merren vesh ndryshe;
- 1.2.6 Çdo frazë që fillon me fjalet "përfshin" ose "duke përfshirë", "ne vecanti", "për shembull", "te tilla si" apo të ngjashme, do të kuptohen si ilustruese dhe pa kufizim ndaj përgjithshmerisë së fjaleve të përgjithshme të lidhura;
- 1.2.7 Referencat në "këtë Kontratë" ose "kjo Kontratë Konçesioni" do të interpretohen si referencë në këtë Kontratë siç mund të ndryshohet ose modifikohet në kohë, si dhe do të përfshijnë referencën në çdo dokument që e ndryshon, modifikon ose e shton atë, ose që është lidhur, bërë ose dhënë në zbatim ose në përputhje me kushtet e saj;
- 1.2.8 Sa herë që kjo Kontratë i referohet një numri "ditësh" ky numër do t'i referohet ditëve kalendarike, përveç kur specifikohen si Ditë Pune;
- 1.2.9 Çdo referencë në "muaj" ose "vit" do të interpretohet si referencë në një muaj kalendarik ose vit kalendarik;



- 1.2.10 Cdo fjalë, term, frazë dhe shkurtim që fillon me shkronjë të madhe e përdorur specifikisht në ndonjë Aneks, Bashkëlidhje a Dokument tjetër bashkangjitur do të ketë kuptimin e përcaktuar në këtë Aneks, Bashkëlidhje a Dokument, sipas rastit;
- 1.2.11 Titujt e përdorur për nenet, paragrafet, nenparagrafet, Anekset dhe tabela e përmbajtjes janë vetëm për lehtësi referimi dhe nuk do të ndikojnë në interpretimin e kësaj Kontrate;
- 1.2.12 Në rast mospërputhjeje midis çdo fjale me gjuhë të madhe, termi të përcaktuar, fraze ose shkurtimi të parashikuara në Nenin 1.1 dhe një dispozite, fjale me gjuhë të madhe, termi, fraze ose shkurtimi parashikuar gjetkë në këtë Kontratë, Aneks, Bashkëlidhje ose në një Dokument tjetër bashkangjitur tek çdo Bashkëlidhje, kuptimi i dhënë në Nenin 1.1 do të ketë përparësi ndaj kuptimit të dhënë në çdo Aneks, Bashkëlidhjeje a një Dokument tjetër bashkangjitur çdo Bashkëlidhjeje, përveç kur konteksti i kësaj Kontrate e kërkon ndryshe;
- 1.2.13 Nje referim tek nje ent shtetror nenkupton referencen tek juridiksioni i tij dhe nese ky ent shtetror:
- (i) zevendesohet nga nje organ/ent tjetër, atëherë i referohet juridiksionit të ketij të fundit;
 - (ii) pushon së ekzistuar, atëherë i referohet juridiksionit të organit/entit, i cili ka kompetenca të përafërta ose të njëjta me organin/entin shtetror që ka pushuar së ekzistuar;
- 1.2.14 Kudo në Kontratë dhe në gjithë dokumentacionin bashkëngjitur asaj, termi "Konçesionar" do të nënkuptojë njëkohësisht edhe termin "Shoqëri Konçesionare";
- 1.2.15 Pa paragjykim ndaj paragrafeve të mësipërme, nëse ka ndonjë konflikt apo mospermbushje ndërmjet nënve dhe Anekseve dhe/ose ndonjë shtojcë të Anekseve dhe/ose cdo dokumenti tjetër që i referohemi në këtë Kontratë, konflikti apo mosperputhja do të zgjidhet sipas rendit të mëposhtëm të përparësive, duke bërë interpretimin me mirëbesim, nisur nga qellimi që kanë patur Palet:
- (i) Kërkesat e Autoritetit Kontraktues (Dokumentat Standarte të Tenderit);
 - (ii) Oferta e Konçesionarit;
 - (iii) Kontrata Konçesionare, Anekset dhe cdo dokument tjetër bashkëlidhur;
 - (iv) cdo dokument tjetër ku Kontrata Konçesionare bën referencë.

2. KUSHTE PARAPRAKE TË DEKLARUARA PËR LIDHJEN E KONTRATES

2.1 Konçesionari deklaron që:

- 2.1.1 Ka bërë dhe do të bëjë kërkimet dhe studimet e tij për zbatimin dhe përmbushjen e detyrimeve të tij bazuar në këtë Kontratë, duke përfshirë informacionin e vënë në dispozicion nga Autoriteti Kontraktues, dokumentet standarte, dhe cdo lloj informacioni të kërkuar nga Konçesionari përpara datës së lidhjes së kësaj Kontrate.
- 2.1.2 Është në dijeni të plotë përsa i përket përmbajtjes dhe kërkesave të Autoritetit Kontraktues të përcaktuar në Aneksin I (Kërkesat e Autoritetit Kontraktues) dhe Aneksin II (Oferta e Konçesionarit).



- 2.1.3 Ka te gjithë informacionin, pajisjet, sistemet dhe personelin e nevojshem dhe te kualifikuar me qellim qe t'i jape mundesi atij te zbatoje detyrimet qe rrjedhin nga kjo Kontrate, duke perfshire mundesine per te permbushur dhe realizuar Projektin Koncesionar.
- 2.1.4 Ne asnje rast nuk do te kerkoje ndonje demshperblim, penalitet apo te ngreje cfaredolloj pretendimi ne lidhje me zbatimin e Kontrates ndaj Autoritetit Kontraktues , apo Enteve Shteterore te tjera , per fakte, rrethana apo ngjarje qe ka dijeni dhe/ose duhet te ishin parashikuar ne projektin dhe Aneksin II (Oferta e Koncesionarit)
- 2.1.5 Koncesionari brenda 2(dy) javeve nga data efektive e kesaj kontrate do te themeloje nje Shoqeri Tregtare ne vazhdim " Shoqeri Koncesionare", te ciles do t'i transferohen te gjitha te drejtat dhe detyrimet e Koncesionarit sipas kesaj Kontrate,.
- 2.1.6 Koncesionari është dakort dhe pranon të marrë në dorëzim, sipas një inventari, QKT Ekzistuese në gjendjen "sic janë" në Datën Efektive të kësaj Kontrate dhe nuk ka asnjë pretendim të tashëm apo të ardhshëm të çfarëdo lloji apo natyre lidhur me to, qoftë edhe për vese të fshehura.
- 2.1.7 Në lidhje me QKT Ekzistuese, Koncesionari, vetë apo nëpërmjet personave fizikë a juridikë, vendas a të huaj të kontraktuar prej tij do të kryejë të gjitha Punimet e Ndërtimit.
- 2.1.8 Koncesionari është dakort dhe pranon të marrë në dorëzim Pajisjet Ekzistuese, sipas një inventari, në gjendjen "sic janë" në Datën Efektive të kësaj Kontrate dhe nuk ka asnjë pretendim të tashëm apo të ardhshëm të çfarëdo lloji apo natyre lidhur me to, qoftë edhe për vese të fshehura. Ai do t'i mirëmbajë ato, duke përjashtuar këtu shpenzimet e jashtëzakonshme, riparimet dhe amortizimin normal te tyre, deri në momentin që do t'ia kthejë mbrapsht Autoritetit Kontraktues sipas Nenit 18.2.8 pasi të instalohen Pajisjet Elektromekanike dhe Kompjuterike te reja.
- 2.1.9 Në lidhje me dhënien e Sheshit, të Drejtës për Kalim, Gëzimit të Qetë dhe të drejtës për akses tek Sheshi Koncesionari e pranon Sheshin "sic është" që nga data e një dhënieje të tillë, si dhe Autoriteti Kontraktues nuk do të kryejë ndonjë shpenzim (as nuk do të jetë përgjegjës për ndonjë Pretendim) kundrejt (ose nga) Koncesionari në lidhje me gjendjen e Sheshit.
- 2.1.10 Te gjitha kontratat qe do te lidhen nga Koncesionari me te trete nuk do te kene periudhe vlefshmerie me te gjate se 3 (tre) muaj pas perfundimit te Periudhes Koncesionare.

2.2 Autoriteti Kontraktues deklaron qe:

- 2.2.1 Në përputhje me Kushtetutën e Shqipërisë në rast ndarje, bashkim ose ndryshim portofolësh eventuale sipas ligjeve në fuqi, shprehja "Autoritet Kontraktor", sipas kësaj kontrate koncesionare do t'i referohet ministrit përgjegjës të ngarkuar për drejtimin e politikave të transportit në Republikën e Shqipërisë.
- 2.2.2 Te gjitha te dhenat e tij te vena ne dispozicion te Koncesionarit duke perfshire dhe Dokumentet e Procedures Konkruuese, jane te sakta, te verteta dhe pa

RE
PUBLIKË
SHQIPËRE
SEK

- gabime.
- 2.2.3 Kjo Kontrate eshte nenshkruar rregullisht nga Autoriteti Kontraktues, i cili gezon te gjitha te drejtat dhe kompetencat ne baze te legjislacionit shqiptar.
 - 2.2.4 Nenshkrimi dhe zbatimi i kesaj Kontrate i nenshtrohet ligjeve ne fuqi te Republikes se Shqiperise.
 - 2.2.5 Asnje urdher, rregull/rregullore, urdher ekzekutimi, vendim, pezullim ose urdher kufizues me karakter administrativ nuk do te zbatohet ose urdherohet te zbatohet nga ndonje organ pushtetit administrativ ose Ent Shteteror qe ka juridiksion mbi ceshtjen qe kufizon, ndalon ose deklarohet te paligjshme aktivitetet e kryera sipas kesaj Kontrate.
 - 2.2.6 Ne cdo rast do t'i siguroje Konkensionarit Gëzim të Qetë, të drejtën për Kalim dhe për Akses tek Sheshi;
 - 2.2.7 Do t'i dorëzojë Konkensionarit bazën e të dhënave kombëtare të mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove te tyre "sic është" dhe nuk mban asnjë përgjegjësi kundrejt Konkensionarit apo të tretëve lidhur me gjendjen e informacionit të regjistruar në të.
 - 2.2.8 Do të beje te gjitha perpjekjet per te asistuar dhe ndihmuar Konkensionarin dhe/ose Shoqerinë Konkensionare gjatë procedurave për pajisje me Leje, licensa.
 - 2.2.9 Do të informojë vazhdimisht publikun, në mënyrë të përshtatshme, në lidhje me faktin që Shërbimi i Kontrollit Teknik të Detyrueshëm të Mjeteve Rrugore me Motor dhe Rimorkiove te tyre do të ofrohet nga Konkensionari duke filluar nga Data Efektive e Kontratës.

2.3 Te dy Palet deklarojne qe:

- 2.3.1 Brenda nje periudhe prej 3(tre) javësh pas Dates Efektive:
 - (i) Autoriteti Kontraktues dhe Konkensionari do te lidhin nje marreveshje uzufukti per krijimin e uzufuktit mbi QKT Ekzistuese ne favor te Konkensionarit pa pagese deri ne perfundim te Periudhes se Konkensionit, afatet dhe kushtet e se ciles duhet te jene te rregullta dhe te arsyeshme konform Ligjit;
 - (ii) Konkensionari do te marre te gjitha hapat e nevojshme per te siguruar krijimin, vendosjen dhe rregjistrimin e menjehershem te uzufuktit perkates mbi QKT Ekzistuese (dhe mbulon te gjitha shpenzimet qe lidhen me kete), me ndihmen e arsyeshme te Autoritetit Kontraktues, pa cenuar detyrimet e tij per te paguar tarifat e rregjistrimit, etj.

3. DHENIA E KONCENSIONIT

3.1 Objekti i Konkensionit

Duke iu nenshtruar dhe ne perputhje me afatet dhe kushtet e percaktuara ne kete Kontrate dhe Anekset bashkelidhur, Autoriteti Kontraktues i jep dhe autorizon Konkensionarin:

- (i) te projektoje, financoje, rehabilitoje, testoje, te kete ne perdorim, te shfrytëzoje dhe mirembaje QKT Ekzistuese dhe Pajisjet Ekzistuese per aq

- kohe sa do t'i kete ne perdorim;
- (ii) të projektojë, financojë, ndërtojë, testojë, të ketë në pronësi dhe në fund të periudhes se koncensionit të transferojë, të shfrytëzojë dhe të mirëmbajë QKT e Re dhe Pajisjet Elektromekanike dhe Kompjuterike (qoftë ato të instaluara në QKT Ekzistuese dhe që do të zëvendësojnë Pajisjet Elzistuese ashtu edhe ato në QKT e Re);
 - (iii) të financojë, testojë, të ketë në pronësi dhe në fund të periudhes se koncensionit të transferojë, të shfrytëzojë dhe të mirëmbajë QKTL dhe pajisjet elektromekanike dhe kompjuterike te saj;
 - (iv) t'iu ofrojë Klientëve Shërbimin e Kontrollit Teknik të Detyrueshëm të Mjeteve Rrugore me motor dhe rimorkiove te tyre në mënyrën e duhur dhe me profesionalizëm, në përputhje me këtë Kontratë, Manualin e Kontrollit të Mjeteve dhe Ligjin në tërësi.

3.2 Periudha e Koncensionit

Koncensionit jepet per nje periudhe prej 10 vitesh nga Data Efektive dhe perfundon ne ditën e pervjetorit te 10 – te te Dates Efektive “Periudha Efektive”. Megjithate ne rastin e zgjidhjes perpara afatit 10 vjecar periudha e Koncensionit do te nenkuptoje dhe do te kufizohet tek periudha qe fillon nga Data Efektive dhe mbaron ne Daten e Zgjidhjes.

3.3 Rastet e zgjatjes se Periudhes se Koncensionit

- 3.3.1 Pas nje periudhe prej 8 vitesh duke filluar nga Data Efektive, Palet bien dakord per te diskutuar pa detyrime, afatet dhe kushtet per nje zgjatje te mundshme te Periudhes se Koncensionit, duke patur parasysh se Autoriteti Kontraktues mund te kerkoje zgjatjen e afatit, ne rastin e ekzistences se interesit publik dhe perputhshmerise me strategjine dhe objektivat e tij ne momentin e negociatave. Cdo zgjatje e afatit mund te reflektohet mbi ato elemente te Kontrates me karakter financiar, ashtu sic mund te gjykohet e arsyeshme dhe e pershtatshme nga Palet.
- 3.3.2 Palet bien dakord se Periudha e Koncensionit do te zgjatet, pa detyrime per Palet, per nje periudhe te caktuar kohe e barabarte me vonesat kohore per shkak te rastit te mospermbushjes nga ana e Autoritetit Kontraktues, per venien ne dispozicion te Koncesionarit te Sheshit.
- 3.3.3 Palet bien dakord se Periudha e Koncesionit do te zgjatet ne rastin e nje Force Madhore, per nje periudhe kohe te barabarte me kohen qe ka zgjatur ngjarja e Forcës Madhore dhe kohen e arsyeshme të nevojitur per riparimin e demeve të shkaktuara.
- 3.3.4 Zbulimi i relikeve kulturore arkeologjike, fosileve, tumave të varrezave dhe përmendoreve, mbetjeve të kaluara artistike dhe çdo sendi tjetër me domethënie arkeologjike, gjeologjike dhe historike në Shesh, që rezultojnë gjatë kryerjes së Punimeve të Ndërtimit dhe që ndërhyjnë në ndërtimin e përfundimin e Punimeve të Ndërtimit nga Konçesionari, me kusht që

zgjatja t'i korrespondojë kohëzgjatjes së rastit përkatës (dhe Palët të kenë të drejtë t'ia referojnë çdo mosmarrëveshje në lidhje me këtë Nen mekanizmit të zgjidhjes së mosmarrëveshjeje të përshkruar në Nenin 32.

3.4 Eksluziviteti dhe kufizimet

- 3.4.1 Koncesionari do të ketë të drejtën ekskluzive në lidhje me Sherbimin gjatë Periudhës Koncesionare dhe në përputhje me Manualin e Kontrollit të Mjeteve.
- 3.4.2 Në asnjë rast Autoriteti Kontraktues nuk do të lidhë dhe/ose të deklarojë të lidhë çfarëdolloj kontrate apo marrëveshje me palë të tretë të cilat mund të japin ose deklarojnë të japin, të drejtat e identifikuar në nenin 3.1 "Dhënia e Koncesionit" një palë të tretë ose të marrë ndonjë veprim duke përfshirë përfundimin e Kontrates e cila mund të ndikojë negativisht në të drejtat ekskluzive të dhëna Koncesionarit sipas kësaj Kontrate.
- 3.4.3 Koncesionari në asnjë rast nuk do të kryejë Sherbimin me nenkontraktorë.

3.5 Autorizime, Leje, Licensa

- 3.5.1 Autoriteti Kontraktues do të sigurojë që çdo Ent Shtetëror nën autoritetin e drejtperdrejtë të tij t'i leshojë Koncesionarit autorizimet, licencat dhe lejet në lidhje me zbatimin e Koncesionit me kusht që Koncesionari të ketë përmbushur kërkesat ligjore për aplikimin për licencat, autorizimet dhe lejet e kerkuara nga ai.
- 3.5.2 Në rastet kur çdo Ent Shtetëror, i cili nuk është nën autoritetin e drejtperdrejtë të Autoritetit Kontraktues, që ka të drejtë të leshojë autorizime, leje, licensa, Autoriteti Kontraktues do të bejë çdo përpjekje për të ndikuar që autorizimet, lejet dhe licencat t'i leshohen Koncesionarit në përputhje me këtë Kontratë, pa vonesa, sipas një kerkese të nevojshme të paraqitur nga Koncesionari, me kusht që ky i fundit të ketë përmbushur kërkesat ligjore për aplikimin për licencat, autorizimet dhe lejet e kerkuara nga ai.
- 3.5.3 Autoriteti Kontraktues do të bejë përpjekjet e duhura që Entet Shtetërore që ushtrojnë autoritetin e tyre përkatës në lidhje me Koncesionarin do të mbështesin pa i shkaktuar Koncesionarit vonesa në zbatimin e Projektit të Koncesionit.

3.6 Dorezimi i Mjediseve të Koncesionit dhe Infrastruktues

- 3.6.1 Në përfundim të Periudhës Koncesionare, Koncesionari do t'i kthejë Autoritetit Kontraktues përdorimin e QKT Ekzistuese;
- 3.6.2 Në përfundim të Periudhës Koncesionare, Koncesionari do t'i transferojë pa pagesë Autoritetit Kontraktues pronësinë mbi QKT e Re, QKTL si dhe mbi të gjitha Pajisjet Elektromekanike dhe Kompjuterike (si ato të QKT Ekzistuese ashtu dhe ato të QKT të Re si dhe QKTL) si dhe, në çdo rast,

SECRETARIA

do të kryejë të gjitha ato veprime të cilat janë pazgjidhshmërisht të lidhura me veprimet e transferimit/kalimit të pronësisë dhe të nënshkruajë të gjitha aktet që do të bëjnë të mundur këtë kalim pronësie.

- 3.6.3 Procesi i Dorëzimit do të fillohet të paktën 6 (gjashtë) muaj përpara mbarimit të Periudhës Koncesionare pas një inspektimi të përbashkët të Autoritetit Kontraktues dhe Koncesionarit.

3.7 Procedura e Dorëzimit në përfundim të Periudhës Koncesionare

- 3.7.1 Në 6 (gjashtë) muajt e fundit të Periudhës Koncesionare, Koncesionari do të fillojë përbushjen e detyrimeve të dorëzimit, siç jepen më poshtë, do të bashkëpunojë me Autoritetin Kontraktues dhe do t'i sigurojë këtij (ose ndonjë pale të tretë të caktuar nëpërmjet saj) të gjithë aksesin dhe informacionin, siç mund të kërkohet ose është e nevojshme për të marrë në ngarkim e shfrytëzimin QKT Ekzistuese, QKT e Re dhe Pajisjet Elektromekanike dhe Kompjuterike. Brenda një periudhe kohe të arsyeshme para mbarimit të Periudhës së Koncesionit, Palët do të takohen periodikisht me qëllim që të bien dakord për procedurat e detajuara të dorëzimit, duke përfshirë zërat e caktuar më poshtë.

a) Menjëherë pas mbarimi të Afatit:

i) QKT Ekzistuese dhe QKT e Re duhet të jenë në një gjendje të arsyeshme mirëmbajtjeje, pastërtie dhe pamjeje, duke marrë parasysh vjetërsinë dhe amortizimin e arsyeshëm, dhe brenda parametrave teknike për një funksionim normal në përputhje me destinacionin e tyre;

ii) të Drejtat Koncesionare do të mbarojnë automatikisht dhe pronësia e QKT së Re, QKTL dhe e Pajisjeve Elektromekanike dhe Kompjuterike do t'i transferohet Autoritet Kontraktues, dhe Koncesionari nuk do të ketë më të drejta t'i përdorë dhe gëzojë ato;

iii) të gjithë kostot, pa asnjë përjashtim, në lidhje me mbarimin automatik të të Drejtave Koncesionare, me transferimin e pronësisë së QKT së Re, QKTL dhe e Pajisjeve Elektromekanike dhe Kompjuterike dhe me dorëzimin e tyre siç përcaktohet më sipër, do t'i ngarkohen dhe do të përballohen vetëm nga Koncesionari;

iv) Kontratat e licencës për përdorimin e programeve kompjuterike (softëare) të jenë të vlefshme për të paktën 3 muaj pas përfundimit të periudhës koncesionare dhe të lejojnë përdorimin e tyre nga Autoriteti Kontraktues. Në çdo rast Koncesionari garanton Autoritetin Kontraktues se do të ketë akses të qetë në bazen e të dhenave të mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove të tyre.

v) Koncesionari do t'i transferojë menjëherë Autoritetit Kontraktues, në masën që ende nuk është transferuar, në çdo rast së bashku me detyrimet përkatëse të lindura gjatë rrjedhës së zakonshme të biznesit duke filluar që nga data e dorëzimit, të gjitha të Drejtat Koncesionare, titujt dhe interesat për QKT Ekzistuese, QKT e Re dhe QKTL si dhe Pajisjet Elektrike dhe


SHOQËRIA

Kompjuterike dhe gjithshka që përfshihet në to, të lira nga çdo detyrim apo barrë, duke përfshirë:

1. të gjitha lëndët e para, pjesët e konsumueshme dhe pjesët e këmbimit,
2. të gjithë pronën e trupëzuar;
3. të drejtat e pronësisë intelektuale që mbaheshin nga Konçesionari ose Shoqëria Konçesionare (ato që burojnë nga pronësia, nga ndonjë licencë ose nga ndonjë burim tjetër), në masën që këto kërkohen në mënyrë të arsyeshme për shfrytëzimin e QKT së Re, QKTL dhe e Pajisjeve Elektromekanike dhe Kompjuterike;
4. të gjitha ndërtimet dhe pjesët e lidhura pazgjidhmërisht me to;
5. librat apo dokumentat e evidencave (records) të kompjuterizuara ose jo, raportet, të dhënat, dosjet dhe informacioni, vizatimet, rezultatet e testeve, dokumentet,
6. të gjitha garancitë e Pajisjeve Elektromekanike dhe Kompjuterike, materialeve dhe punimeve,
7. të gjitha të drejtat kontraktore, duke përfshirë qiratë dhe policat e sigurimit,
8. të gjitha punimet në proces (duke përfshirë Punimet e Ndërtimit, nëse ka) në bazë të kontratave me shitës, furnizues, kontraktorë dhe nënkontraktorë,
9. kontratat e licensës për përdorimin e programeve kompjuterike, të cilat duhet të parashikojnë zëvendësimin e Konçesionarit nga Autoriteti Kontraktues, në masën që këto kërkohen në mënyrë të arsyeshme për shfrytëzimin e QKT së Re, QKTL dhe e Pajisjeve Elektromekanike dhe Kompjuterike; dhe
10. të gjitha të drejtat në lidhje me çdo shumë sigurimi për t'u paguar në emër dhe për llogari të Konçesionarit, por e papaguar në datën e zgjidhjes së kësaj Kontrate, në lidhje me të drejtat, titujt dhe interesat e Konçesionarit në Projekt Koncesionar;

vi) Kontratat e punës mes punëmarrësve dhe Shoqërisë Koncesionare do të jenë për një periudhë kohe me afat prej jo më shumë se tre muaj pas përfundimit të periudhës koncesionare. Koncesionari njih detyrimin t'i bëjë të ditur çdo punëmarrësi këtë fakt në kontratën individuale të punës.

vii) Koncesionari do të kryejë të gjitha veprimet e nevojshme për të zbatuar çdo transferim të parashikuar në këtë Nen, duke përfshirë nënshkrimin e çdo dokumenti të kërkuar, si dhe lidhjen me Autoritetin Kontraktues të çdo akti, kontrate ose marrëveshjeje të nevojshme dhe pa asnjë kosto ose shpenzim për Autoritetin Kontraktues (përveçse rastit siç parashikohet shprehimisht në



nënparagrafin (viii) më poshtë); dhe
viii) Autoriteti Kontraktues do të jetë përgjegjës për pajisjen ose dhënien, me shpenzimet e tij, të të gjitha Autorizimeve për të shfrytëzuar QKT së Re, QKTL dhe e Pajisjeve Elektromekanike dhe Kompjuterike (ose për të transferuar shfrytëzimin e tyre tek një palë e tretë), si dhe Konçesionari do të ndihmojë Autoritetin Kontraktues për identifikimin dhe marrjen e çdo Autorizimi të tillë, duke përfshirë dhënien e ndihmës së arsyeshme në përgatitjen e kërkesave në lidhje me to.

b) Në rast zgjidhje para Afatit të kësaj Kontrate, kërkesat e pikës (a) të këtij Neni do të zbatohen *mutatis mutandis* edhe për këto raste.

3.7.2 Autoriteti Kontraktues bie dakord dhe merr persiper që brenda 15 (pesëmbëdhjete) diteve nga transferimi i te drejtave dhe titujve në lidhje me asetet dhe dorezimin e dokumenteve perkatëse sic është parashikuar në paragrafet më lart, ai do të leshojë Çertifikaten e Pranimit të Dorëzimit në përputhje me Aneksin III (Çertifikata e Pranimit të Dorëzimit) të kesaj Kontrate. Konçesionari duhet të dorëzojë keto asete në gjendje funksionale.

3.7.3 Ndersa të gjitha asetet e sipërpermendura të Shoqërisë Konçesionare do të transferohen tek Autoriteti në ditën e përfundimit të Periudhës Konçesionare, vetë Shoqëria Konçesionare si dhe Konçesionari me asetet e tij nuk do të transferohen tek Autoriteti Kontraktues.

4 DATA EFEKTIVE E KONTRATES

4.1 Data Efektive e kesaj Kontrate do të jete ditën e nënshkrimit të kesaj Kontrate nga ana e Autoritetit Kontraktues dhe Konçesionarit.

4.2 Në rast se nga Data Efektive Konçesionari nuk fillon permbushjen e detyrimeve perkatëse kontraktore sipas kesaj Kontrate brenda nje periudhe prej 2 (dy) javesh, Autoriteti Kontraktues do të kete te drejten te zgjidhe Kontraten ne menyre te menjehershme. Në vijim, Palet në kete Kontrate nuk do të kene te drejta apo detyrime te metejshme (perveç te drejtave dhe detyrimeve te tilla te parashikuara ne Nenin 21 Konfidentaliteti)

5 PLANI I PROJEKTIT

Konçesionari do të realizojë projektin në përputhje me Planin e Projektit të parashikuar në Aneksin VII.

6 TESTIMI

6.1 Konçesionari, para ofrimit të Shërbimit sipas kësaj Kontrate (me pajisjet e reja), do të kryejë, me shpenzimet e veta, testet e funksionimit të Pajisjeve

Elektromekanike dhe Kompjuterike sipas normave të Manualit të Kontrollit të Mjeteve në përputhje me specifikimet teknike në Dokumentat Standarte të Tenderit dhe procedurat e parashikuara në Ligj.

Kur Koncesionari i kalon me sukses procedurat e testimit, dhe depoziton pranë Autoritetit Kontraktues aktin përkatës të testimit, Autoritetit Kontraktues do të leshojë një Certifikatë Pranimit brenda 7 (shtatë) ditësh. Leshimi i një Certifikate të tillë konfirmon konceptimin, zhvillimin dhe realizimin e projektit në përputhje me këto Kontrate. Pavarësisht nga leshimi i çfarëdo Certifikate Pranimit, Koncesionari do të mbetet i vetmi përgjegjës për të siguruar që Projekti, siç është konceptuar, zhvilluar dhe zhvilluar, të jetë i përshtatshëm për realizimin e tij, në përputhje me këto Kontrate.

- 6.3 Nëse Autoriteti Kontraktues, brenda një periudhe 15 (pësemëdhjetë) ditore nga dita që është njoftuar nga Koncesionari në përputhje me paragrafin 6.2 më sipër, nuk lëshon apo nuk refuzon lëshimin e Certifikatës së Pranimit Koncesionarit atëherë Projekti do të konsiderohet i realizuar në përputhje me Kontraten dhe Certifikatën e Pranimit si e lëshuar.
- 6.4 Të gjitha shpenzimet për kryerjen e Testimit do të perballohen nga Koncesionari.

7 VONESAT NE ZBATIM-DISPOZITA TE PERGJITHSHME

- 7.1 Nëse, në çdo kohë, Koncesionari është në gjendje të parashikojë se ai nuk do të (apo se ka pak të ngjarë që të) arrijë cilindo nga afatet e parashikuara në Aneksin II "Oferta e Koncesionarit", Aneksin VII (Plani i Projektit), ai do të njoftojë menjëherë Autoritetin Kontraktues mbi faktin e Vonesës duke bërë një përmbledhje të ngjarjeve, fakteve dhe shpjegimeve përkatëse që mund të sjellin vonesë.
- 7.2 Koncesionari, sa më shpejt që të jetë e mundur dhe në çdo rast jo më vonë se sa 10 (dhjetë) ditë pune pas njoftimit sipas nenit 7.1 më sipër, do t'i japë Autoritetit Kontraktues hollësi të plota me shkrim për:
- (i) Arsyet e Vonesës
 - (ii) Pasojat e Vonesës
 - (iii) Nëse Koncesionari pretendon se Vonesa vjen për shkak të Autoritetit, arsyen pse e paraqet atë pretendim
- 7.3 Çfarëdo konflikti mes Paleve, si rrjedhojë e vonesave do të zgjidhet përmes procedurës për zgjidhjen e mosmarreveshjeve të parashikuara në Aneksin X. Gjate kohës së zgjidhjes së mosmarreveshjeve të dy palëve do të vazhdojnë të punojnë për të zgjidhur shkaqet apo për të zvogëluar pasojat e vonesës.
- 7.4 Nëse nuk është e mundur Koncesionari do të paraqesë një projekt të planit të korigjimit, në rast se nuk është në gjendje të arrijë afatet e parashikuara sipas planeve vjetore të deklaruara prej tij. Projekt-Plani i Korigjimit do të identifikojë çeshtjet që rrjedhin nga Vonesa dhe hapat që Koncesionari propozon që të ndermerren për të arritur afatet në përputhje me këto Kontrate.
- 7.5 Projekt-Plani i Korigjimit do t'i paraqitet Autoritetit Kontraktues për miratim sa më shpejt që të jetë e mundur dhe në çdo rast jo më vonë se 10 (dhjetë) ditë pune, në mënyrë që Autoriteti Kontraktues të mund të lejojë dhe të njoftojë Koncesionarin me shkrim pas njoftimit fillestar sipas nenit 7.1. Autoriteti Kontraktues nuk do të



refuzoje miratimin e tij per nje Projekt-Plan Korrigjimi ne menyre te paarsyeshme. Autoriteti Kontraktues do te shprehet mbi propozimin e Koncesionarit brenda 10 (dhjetë) diteve pune nga paraqitja e kerkeses, ne rast te kundert propozimi konsiderohet i miratuar nga ana e Autoritetit Kontraktues.

7.6 Koncesionari do te veproje ne perputhje me Planin e tij te Korrigjimit.

8 ÇËSHTJE FINANCIARE

8.1 Tarifa e Koncesionit

8.1.1 Koncesionari detyrohet t'i paguajë Autoritetit Kontraktues një Tarifë Koncesioni të barabartë më 5 % (pesë përqind) të Xhiros Vjetore (para tatim fitimit) që Koncesionari do të grumbullojë nga Tarifat e Kontrollit dhe të Rikontrollit (duke përfshirë TVSH-ne), bazuar ne deklaratimet financiare te kontrolluara te Shoqerise Koncesionare per cdo Vit Financiar.

8.1.2 Detyrimi i Koncesionarit per pagesen e Tarifes se Koncesionit, fillon nga Data Efektive dhe paguhet me keste mujore brenda dates 15 (pesembedhjetë) te muajit pasardhes.

8.1.3 Me mbylljen e vitit financiar dhe certifikimin e bilancit Palet do te bejne rakordimet lidhur me Tarifen Koncesionare

8.2 Tarifat e Kontrollit

8.2.1 QKT Ekzistuese dhe QKTL do të aplikojnë Tarifat e Kontrollit Ekzistuese siç përcaktohet në tabelën A e Aneksit VIII bashkëngjitur kësaj Kontrate deri në përfundim të Fazës Ndërtimore të QKT Ekzistuese. Tarifat e Kontrollit të reja do të jenë sipas tabelës B të Aneksit VI bashkëngjitur kësaj Kontrate dhe do të fillojnë të aplikohen pas përfundimit të Fazës Ndërtimore të QKT Ekzistuese. Ndërtimi dhe vënia në funksionim e QKT së Re duke qenë më pas në kohë krahasuar më QKT Ekzistuese do të fillojë të aplikojë Tarifat e Kontrollit të reja menjëherë pas përfundimit të Fazës Ndërtimore të saj.

~~Tarifat e Kontrollit Ekzistuese do të arkëtohen dhe do të përbëjnë të ardhura të Koncesionarit duke filluar nga Data Efektive.~~

8.2.2 Tarifat e Kontrollit do të rishikohen, çdo 3 (tre) vjet bazuar në Normën e Inflacionit, sipas formulës në vijim:

$$IR = (NI^{(2)} - NI^{(1)})/NI^{(1)}$$

- "IR" do të thotë Indeksi i Rishikimit të Tarifave të Kontrollit;

- "NI⁽¹⁾" do të thotë Norma e Inflacionit në vitin e 3-të (tretë) pararendës të vitit në të cilin do të kryhet rishikimi i Tarifave të Kontrollit; dhe

- "NI⁽²⁾" do të thotë Norma e Inflacionit në vitin në të cilin do të kryhet rishikimi i Tarifave të Kontrollit.



Do të merret për bazë Norma e Inflacionit e deklaruar në baza 3 mujore ose 6 mujore ose 9 mujore ose 12 mujore në varësi të Datës Efektive.

8.2.3 Në rast të ndryshimit të procedurave të kontrollit gjatë ofrimit të Shërbimit të Kontrollit të Detyrueshëm Teknik të Mjeteve Rrugore me Motor dhe Rimorkiove të tyre sipas kërkesave me shkrim të MPPTT, Konçesionari ka të drejtë të rrisë Tarifat e Kontrollit ekzaktësisht me atë shumë që reflekton rritjen në kosto dhe shpenzimet shtesë si rezultat i ndryshimit të procedurave në fjalë. Për këtë qëllim përpara ndryshimit të cdo procedure Autoriteti Kontraktor miraton paraprakisht vlerën e investimit dhe ndikimin e pritshëm në tarifë, të propozuara nga Konçesionari. Në përfundim të investimit dhe testimit të tij në përputhje me ligjet në fuqi brenda 7 diteve aplikohet Tarifa e Re.

8.3 Tarifa e Rikontrollit

8.3.1 Tarifat e rikontrollit ndjekin të njëjtin rregullim si Tarifat e Kontrollit. I vetmi ndryshim prej këtyre të fundit ka të bëjë me vlerën e tyre, e cila do të jetë:

8.3.1.1 Në rast të rikontrollit të parë brenda një periudhe prej 30 (tridhjetë) ditësh nga dita e kontrollit të parë, 40 % e Tarifës së Kontrollit në rast të përdorimit të linjave të kontrollit dhe 20% e Tarifës së Kontrollit në rast të mospërdorimit të linjave të kontrollit ;

8.3.1.2 Për cdo rikontroll të mëposhtëm pavarësisht numrit të tyre brenda periudhës prej 30 ditësh nga dita e kontrollit të parë, tarifa e rikontrollit do të jetë 50 % e Tarifës së Kontrollit në rast të përdorimit të linjave të kontrollit dhe 20% në rast të mospërdorimit të linjave të kontrollit .

8.3.1.3 Cdo rikontroll i kryer pas periudhës 30 ditore të lartpërmendur do të konsiderohet kontroll nga e para dhe për pasojë do të aplikohen Tarifat e plota të Kontrollit.

8.4 Vlera e Investimit

Vlera që Konçesionari do të investojë për të bërë të mundur ofrimin e Shërbimit të Kontrollit Teknik të Detyrueshëm të Mjeteve Rrugore me Motor dhe Rimorkiove të tyre sipas kësaj Kontrate do të jetë 561.003.000 (pesëqind e gjashtëdhjetë e një milion e tre mijë) Lekë, nga të cilat 267.402.000 (dyqind e gjashtëdhjetë e shtatë milion, e katërqind e dy mijë) Lekë do të destinohen për Pajisjet Elektromekanike dhe Kompjuterike.

8.5 Vlera e Riinvestimit

Vlera e Riinvestimit që Konçesionari do të investojë me qëllim mirëmbajtjen dhe kthimin tek Autoriteti Kontraktues të makinerive, pajisjeve dhe sistemit kompjuterik të QKT në gjendje të përshtatshme për funksionim do të jetë 172.000.000 (njëqind e shtatëdhjetë e dy milion) Lekë që përfaqëson 30,7 % (tridhjetë pikë shtatë përqind) të Vlerës së Investimit dhe do të riinvestohet brenda 3 (tre) viteve të fundit të Periudhës së Konçesionit.

Norma e riinvestimit do të sigurojë që Qendrat e Kontrollit Teknik të jenë gjithnjë në funksionim të mirë. Kjo vlerë është kusht i panegociueshem i Kontrates dhe nuk mund të ndryshohet në rast të Ndryshimit të Kontrates.

Në rast se 4 (kater) muaj para perfundimit të Periudhës Koncesionare Koncesionari nuk ka kryer plotësisht apo pjesërisht riinvestimin detyrohet:

a) t'i paguaje menjëherë Autoritetit Kontraktues diferencën e Vlerës së Riinvestimit të pakryer mbi 56 100 300 leke kur Vlera e Riinvestimit të pakryer është më e madhe se kjo shumë, ndërsa pjesa e mbetur paguhet ditën e fundit të Periudhës Koncesionare;

b) t'i paguaje Autoritetit Kontraktues Vlerën e Riinvestimit të mbetur, nëse ka të tilla, në ditën e fundit të Periudhës Koncesionare, kur Vlera e Riinvestimit të pakryer është më e vogël se 56 100 300 leke.

8.6 Rishikimi i kostove dhe shpenzimeve

Në rast se secila nga Palet do të kërkojë rishikim të kostove dhe shpenzimeve të Koncesionit, duhet të njoftojë Palen tjetër me shkrim, duke respektuar Procedurën e Ndryshimeve të Kontrates, sipas kësaj Kontrate. Brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga marrja e njoftimit, Palet do të takohen dhe do të diskutojnë mbi rishikimin e kostove dhe shpenzimeve.

8.7 Financimi i Koncesionit

Financimi i Koncesionit do të kryhet nga Konçesionari nëpërmjet kapitalit të Shoqërisë Koncesionare (ky financim duhet të përbejë minimumi 20% të burimeve financiare), huave të dhëna nga shoqëritë e grupit SGS apo jashtë saj, apo në çdo mënyrë tjetër të nevojshme për realizimin e Investimit

8.8 Pagesa e Kompensimit

8.8.1 Koncesionari ka depozituar në favor të Ministrisë, direkt ose përmes Shoqërisë Koncesionare, brenda afatit të përcaktuar në Dokumentacionin Standart të Tenderit pagesën e kompensimit në një vlerë prej 16.075.569 (gjashtëmbëdhjetë milionë e shtatëdhjetë e pesë mijë e pesëqind e

gjashtedhete e nente) Leke, shume e cila do te sherbeje per kompensim e detyrimeve sipas percaktimeve te Kodit te Punes te te gjithë punësuarve me te cilet do te nderpriten marrëdhëniet e punes gjate procesit te ristrukturimit.

8.8.2 Lidhur me detyrimet ndaj punonjësve që do të largohen nga puna gjatë procesit te ristrukturimit, Konçesionari nuk do te jete pergjegjes per as shume tjeter pervec pageses se shumës së kompensimit te parashikuar kështu më sipër ne piken 8.8.1.


8.8.3 Autoriteti Kontraktues nuk detyrohet per asnje shume, qe eshte rezultim mosrespektimit nga Konçesionari te procedures per pushim nga puna, afatit per pushim nga puna dhe qe rrjedh për pushim nga puna te punësuarve nga ana e Konçesionarit për shkaqe të paarsyershme apo pajustificuara.

8.9 Tarifa e ATRAKOS-s

Ne zbatim te VKM-se nr. 150, dt. 22.3.2007 "Per Organizimin dhe funksionimin e Agjensise se Trajtitimit te Konçesioneve", Konçesionari detyrohet t'i paguajë ATRAKO-s shumën e pakthyeshme prej 5 610 000 (pesemilion e gjashtëqind e dhjete mije e tridhjete) Leke qe perben 1% Vleres se Investimit.

9 KONÇENSIONARI DHE SHOQERIA KONÇENSIONARE

- 9.1 Konçesionari me qëllim zbatimin dhe përmbushjen e kushteve të kësaj Kontrate është i detyruar të themelojë një Shoqëri Konçesionare sipas legjisllacionit shqiptar, të cilës duhet t'i transferojë të drejtat dhe detyrimet e kësaj Kontrate Konçesionari. Gjatë gjithë Periudhës Konçesionare Konçesionari dhe Shoqëria Konçesionare do të jenë debitorë solidarë për zbatimin dhe përmbushjen e kushteve të Kontratës së Konçesionit dhe çdo veprimtari tjetër ndihmëse apo plotësuese në funksion të zbatimit dhe përmbushjes së kushteve të Kontratës së Konçesionit.
- 9.2 Shoqëria Konçesionare gjatë Periudhes Konçesionare do të ketë si ortak vetëm Konçesionarin.
- 9.3 Shoqëria Konçesionare do të ketë si objekt ekskluziv të sajin zbatimin dhe përmbushjen e kushteve të kësaj Kontrate Konçesionari si dhe të çdo aktiviteti tjetër ndihmës apo plotësues në funksion të zbatimit dhe përmbushjes se kushteve të kësaj Kontrate Konçesionari.
- 9.4 Objekti i aktivitetit te Shoqerise Konçesionare do te kufizohet vetem në përmbushjen e detyrimeve te percaktuara ne kete Kontrate Konçesionare ndersa Konçesionari nuk do te themeloje drejtpersedrejti apo terthoraz ndonje dege apo filial ne territorin e Republikes se Shqiperise objekti i s ciles perfshin mirembajtjen dhe riparimin e mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove te tyre per te trete.
- 9.5 Konçesionari nuk do te transferoje ne favor te ndonje pale te trete kuotën e tij ne Shoqerine Konçesionare pa miratimin paraprak me shkrim të



Autoritetit Kontraktues. Transferimi nuk mund te kryhet pa u realizuar investimi i parashikuar ne Nenin 8.4.

10 NËN-KONTRAKTIMI

- 10.1 Koncesionari mund te nënkontraktoje detyrimet e tij sipas kesaj Kontrate, perjashtuar Sherbimin, me miratim të mëparshëm të Autoritetit Kontraktues, brënda 1 (një) jave nga dita e njoftimit nga Koncesionari dhe i cili nuk do të refuzohet apo vonohet pa shkaqe të arsyeshme. Në rast se, Autoriteti Kontraktues nuk kthen përgjigje brënda afatit të sipërshtuar, nënkontraktimi do të konsiderohet i miratuar. Per menjanimin e ndonje keqkuptimi furnizuesit e pajisjeve, materialeve dhe/ose dergesave nuk do te konsiderohen nën-kontraktore sipas kesaj Kontrate.
- 10.2 Autoriteti Kontraktues do te beje vleresimin e nenkontraktoreve te propozuar nga ana e Koncesionarit bazuar ne kushtet e vendosura ne Aneksin V te kesaj Kontrate.
- 10.3 Koncesionari do te njoftoje Autoritetin per Nen-Kontraktuesin me informacionin e meposhtem:
- (i) Emrin e tij, Eksperiencen dhe adresen;
 - (ii) Qellimet per te cilat nen-kontraktuesi i propozuar do te kontraktohet, duke perfshire cdo sherbim qe do te ofrohet nga nen-kontraktuesi i propozuar;
 - (iii) Vleren e nenkontrates;
 - (iv) Dokumentacioni sipas Aneksit V.
- 10.4 Koncesionari do të jetë i vetmi përgjegjës para Autoritetit Kontraktues për të gjitha dëmet, mospërmbushjet dhe veprimet a mosveprimet jo në përputhje me këtë Kontratë e që mund të shkaktojnë Nën-Kontraktorët e tij.

11 NJËSIA E ZBATIMIT TË PROJEKTIT

- 11.1 Brenda një muaji nga Data Efektive, me Urdher te Ministrit te MPPTT krijohet Njësia e Zbatimit të Projektit Koncesionar ("NjZP") ne MPPTT. Perberja dhe pergjegjesite e NjZP percaktohen ne Urdhrin e Ministrit. Ky Urdher nuk permban detyrime te Koncesionarit ndaj NjZP.
- 11.2 Puna e NjZP do të vazhdojë gjatë gjithë Periudhes Koncesionare.

12 KONTROLLI DHE MONITORIMI

- 12.1 Brenda Periudhes së Koncesionit Autoriteti Kontraktues do të kontrollojë dhe monitorojë periodikisht dhe vazhdimisht Koncesionarin lidhur me zbatimin e kushteve të Koncesionit në formën që do ta gjykojë të përshtatshme dhe të arsyeshme.



- 12.2 Konçesionari është i detyruar t'i paraqesë Autoritetit Kontraktues një raport të përvitshëm, jo më vonë se 3 (tre) muaj nga përfundimi i çdo viti kalendarik, lidhur me parametrat kyç të Konçesionit dhe mënyrën se si po e zbaton atë.
- 12.3 Konçesionari është i detyruar t'i paraqesë Autoritetit Kontraktor raporte mujore lidhur me parametrat kyç të operimit të Konçesionit siç përcaktohet tek Manuali i Kontrollit të Mjeteve, si dhe informacione shtesë të kërkuara nga Autoriteti Kontraktues.
- 12.4 Konçesionari, është i detyruar të marrë pjesë në një mbledhje të përvitshme me MPPTT me qëllim kontrollin e efektshmërisë së Konçesionarit gjatë Periudhes Koncesionare të tij dhe ofrimin e Shërbimit të Kontrollit Teknik të Detyrueshëm të Mjeteve Rrugore me Motor dhe Rimorkiove.
- 12.5 Autoriteti Kontraktues do të ketë të drejtë që brenda orarit të punës të jetë i pranishëm ose të vëzhgojë metodat dhe inspektimet e kontrollit të cilësisë për të konfirmuar se çdo Shërbim përputhet me kërkesat e kësaj Kontrate. Konçesionari do të ndihmojë në kryerjen e këtyre kontrolleve. Nëse Shërbimi nuk arrin të jetë në përputhje me ndonjë aspekt thelbësor të kërkesave të kësaj Kontrate (duke përfshirë kërkesat për cilësinë ose sigurinë), Autoriteti Kontraktues mund ta njoftojë Konçesionarin për këtë mospërbushje. Konçesionari do ta beje korigjimet e nevojshme brenda 10 (dhjetë) ditë pune nga njoftimi i Autoritetit Kontraktues.
- 12.6 Kontrolli nga organet e tjera shtetërore
Pa cenuar dispozitat e tjera të kësaj Kontrate Autoriteti Kontraktues njih dhe pranon të gjitha testet e përmbushjes dhe kontrollet që behen nga cdo dhe të gjitha entet shtetërore që janë organe përgjegjëse sipas Ligjit për keto kontrolle.
Konçesionari është i detyruar që t'i dorëzojë Autoritetit Kontraktues të gjitha raportet, aktet dhe certifikatat e leshuara për punimet e ndertimit nga entet shtetërore.

13 RREGJISTRA DHE RAPORTE

Palet do të veprojnë në përputhje me dispozitat e Aneksit I (Kërkesat e Autoritetit Kontraktues) dhe Aneksit II (Oferta e Konçesionarit) dhe me praktiken ligjore të fushave përkatëse, lidhur me mbajtjen e të dhënave dhe berjen e raporteve. Ato kanë detyrimin t'u japin njera-tjetër informacionin që u kërkohej në lidhje me veprimtarinë, objektin e Kontrates.

14 GARANCITE

- 14.1 Ligjet e miratuara pas hyrjes në fuqi të kësaj Kontrate, të cilat kanë fuqi në R.SH- se dhe ndikojnë ose kufizojnë të drejtat ekskluzive të Konçesionarit janë të zbatueshme deri në atë masë sa të mos ndikojnë në të drejtat e percaktuara në këtë Kontrate.

- 14.2 Ne asnje rast ligjet e miratuara pas hyrjes ne fuqi te kesaj Kontrate, nuk do te cenojne Periudhen Koncesionare te kesaj Kontrate.

15 PUNESIMI

- 15.1 Me hyrjen ne fuqi te Kontrates Koncesionare dhe dorezimin e Sheshit dhe te Pajisjeve Ekzistuese tek Koncesionari, ky i fundit detyrohet te vazhdoje Marredheniet Juridike te Punes sipas kontratave ekzistuese individuale te punes ne perputhje me nenin 138 te K. të Punës te R.SH-se "Transferimi i Ndermarrjes".
- 15.2 Koncesionari do te siguroje personel te mjaftueshem ne menyre qe te plotesoje kerkesat e percaktuara ne kete Kontrate dhe ne Kodin Rrugor te RSH. Koncesionari do te beje perpjekje per te nxitur punesimin ne zonat ku shtrihet projekti.
- 15.3 Koncesionari do te beje perpjekjet e tij me te mira per te siguruar mbajtjen e personelit te kualifikuar gjate gjithe kohes se funksionimit te Sherbimit dhe te siguroje mbajtjen e personelit te kualifikuar ne nivel drejtuesish dhe te siguroje qe cdo zevendesues do te jete i kualifikuar dhe me pervojen e pershtatshme dhe teresisht kompetent per te zbatuar detyrat e caktuara te personit te cilin ai/ajo ka zevendesuar.

16 SIGURIMI

- 16.1 Gjate gjithe Kohezgjatjes se Kontrates, me qellim garantimin e nje aktiviteti te pandërprere Koncesionari duhet te beje sigurimin e asetëve ekzistuese dhe te krijuara sipas vleres kontabile te pasqyruar ne bilanc, nga cdo ngjarje, rrethane apo Force Madhore, brenda kufijve te pergjegjesise qe mbulohen me sigurim, jo me pak se 70% te vleres se investuar. Per kete qellim, Shoqeria Koncesionare do te paraqese cdo vit prane Autoritetit Kontraktues dokumentin perkates qe verteton sigurimin, leshuar nga institucioni perkates.
- 16.2 Sigurimi do te kryhet per klasen 1, 2, 8, 9, 10, 13 dhe 17, te nenit 7 te Ligjit nr.9267, date 29.07.2004 "Per veprimtarine e sigurimit, te risigurimit dhe ndermjetesimit ne sigurime dhe risigurime".

17 DETYRIMET E AUTORITETIT KONTRAKTUES

Pervercse kur eshte parashikuar ndryshe ne kete Kontrate, Autoriteti Kontraktor merr persiper edhe detyrimet e meposhtme:

- 17.1 Te siguroje vazhdimesine e Kontrates, pavaresisht ndryshimeve te objektive strategjike kombetare dhe politikave makro-ekonomike te qeverise dhe legjislacionit rrugor ne R.SH-se.
- 17.2 T'i siguroje Koncesionarit te dhena dhe informacionin e nevojshem per



automjetet nga Baza e te Dhenave Kombetare te Automjeteve, te rendesishme per permbushjen e detyrimeve te tij ne Kontrate, dhe/ose te dhena e informacion qe kerkohen per menaxhimin, operimin dhe zhvillimin e Projektit Koncesionar (gjithmone nese Autoriteti i disponon keto te dhena apo informacione), dhe te informoje Koncesionarin per cdo ngjarje ne lidhje me objektin e Koncesionit, dhe t'i dorezoje Koncesionarit kopje te ketij informacioni dhe te dhenave.

- 17.3 Te specifikoje standartet dhe objektivat e punes te perfshira here pas here tek Manuali i Kontrollit te Mjeteve.
- 17.4 T'i siguroje Koncesionarit Manualin e Kontrollit Teknik te Mjeteve te miratuar nga Ministri i MPPTT brenda 3 (tre) muajve nga Data Efektive.
- 17.5 T'i siguroje dorezimin dhe perdorimin e lire ne QKT-ve Ekzistuese dhe dhe te lejoje Koncesionarin te perdore pajisjet ekzistuese ne faze te pare.
- 17.6 Te dorezoje inventarin e sakte te QKT-ve Ekzistuese.
- 17.7 Te siguroje qe Koncesionarit t'i jepen, pa pagese ose detyrim financiar te gjitha te drejtat e servitudit te perdorimit dhe lehtesira te tjera te kerkuara ne prone shtetore nga Koncesionari per te zbatuar detyrimet e tij sipas kesaj Kontrate. Perdorimi i territorit te QKT do te jete ekskluzivitet i Sherbimit, ku perfshihen te gjitha ambientet e jashtme ne te cilat perfshihen edhe zonat e parkimit , ne rast se ka te tilla.

Nese Koncesionarit i lind nevoja e fitimit te te drejtave te kalimit, lehtesirat dhe te drejtave te tjera reale te tjera mbi pasuri te paluajtshme ne prone private per realizimin e projektit, Koncesionari ka te drejte t'i kerkoje Autoritetit Kontraktor nisjen e procedurave te shpronesimit, dhe ky i fundit detyrohet te nise procedurat e shpronesimit me shpenzimet e Koncesionarit. Shpronesimet, per efekt te kalimit, lehtesirave dhe/ose servitudeve ne prone private, do te paraqiten paraprakisht nga Koncesionari ne Projektin Perfundimtar dhe do te behen te detyrueshme per Autoritetin Kontraktor nese ky i fundit i miraton ato.

- 17.8 Te zbatoje detyrimet e tij ne perputhje me Nenin 3.5 ne lidhje me marrjen e licensave, lejeve dhe autorizimeve qe do t'i sherbejne Koncesionarit per ushtrimin e te drejtave e detyrimeve ne zbatimin e kesaj Kontrate.
- 17.9 Te siguroje se te gjitha te dhenat e tij te vena ne dispozicion te Koncesionarit, duke perfshire dhe Dokumentet e Procedures Konkurruese jane te sakta, te verteta dhe pa gabime.
- 17.10 **Rastet e mospermbushjes se detyrimeve nga Autoriteti Kontraktor**

Secili nga rastet qe vijojne perbejne rastet e mospermbushjes se detyrimeve nga Autoriteti Kontraktor, pervec kur kjo vjen si rezultat i Rasteve te Forces Madhore:

- (i) Autoriteti Kontraktor apo cdo Ent Shtetoror ne varesi te tij nuk permbush ndonje nga detyrimet e tij sipas kesaj Kontrate dhe njekohesisht nuk e ndreq kete mospermbushje brenda afatit perkates te ndreqjes se caktuar ne kete Kontrate per nje rast specifik, dhe nese nuk behet fjale per kete rast, pas nje afati jò



- me pak se 60 dite pune.
- (ii) Autoriteti Kontraktues nuk e njeh kete Kontrate ose ne nje menyre tjeter le te kuptoje qellimin e saj per te mos qene me e detyruar sipas kesaj Kontrate.
 - (iii) Autoriteti apo cdo Ent Shteteror ne varesi te tij, si rrjedhoje e veprimeve/mosveprimeve te tyre si dhe atehere kur duhet, sipas kesaj Kontrate, krijojne rrethana te tilla qe nuk e lejojne Koncesionarin te permbushë detyrimet e tij sipas kesaj Kontrate dhe nuk e ndreqin kete mospermbushje brenda 15 diteve pas mbarimit te periudhes se ndreqjes se lajmeruar nga Koncesionari, ne perputhje me piken (i) si me siper.
 - (iv) Cdo deklarimi bere ose garanci e dhene nga Autoriteti Kontraktues ne kete Kontrate zbulohet qe eshte fals, i pasakte ose i pavertete.

18 TE DREJTAT DHE DETYRIMET E KONCESIONARIT

Pervec sa eshte parashikuar ne kete kontrate, Koncesionari ka dhe keto te drejta e detyrime:

18.1 Te Drejtat e Koncesionarit

Pervec te drejtave qe lindin nga dhenia e Koncesionit, Koncesionari gezon te drejtat e meposhtme:


- 18.1.1 Te ushtroje te gjitha te drejtat ne lidhje me perdorimin eskuziv te Sheshit dhe te Pajisjeve Ekzistuese, dhe te Pajisjeve Elektromekanike dhe Kompjuterike (nga data e instalimit), sipas pershkrimet ne Anekset I dhe II te kesaj Kontrate.
- 18.1.2 Te punesoje apo angazhoje punonjes me qellim zbatimin e Koncesionit si dhe te hartoje politiken e vet te punesimit ne perputhje me ligjet ne fuqi dhe kete Kontrate.
- 18.1.3 Te kryeje veprime te tjera qe i konsideron te nevojshme per te permbushur detyrimet dhe te ushtroje te drejtat e tij sipas kesaj Kontrate.
- 18.1.4 Te kerkoje zgjatjen e Periudhes se Koncesionit ne perputhje me parashikimet e kesaj Kontrate.

18.2 Detyrime te Pergjithshme te Koncesionarit

- 18.2.1 Te zbatoje Projektin e Koncesionit ne perputhje me dispozitat e kesaj Kontrate dhe Anekset e saj.
- 18.2.2 Brenda 5 muajve, Koncesionari duhet te kete perfunduar rehabilitimin e QKT-ve Ekzistuese si dhe ne perputhje me Ligjin. Afati per cdo qender fillon te llogaritet ne momentin e miratimit te lejes se ndertimit sipas Ligjit. Ne cdo rast, Koncesionari eshte i detyruar te aplikojë sipas Ligjit per te gjitha Lejet e ndertimit te QKT-ve Ekzistuese brenda 40 (dyzetë)

ditëve nga Data Efektive.

18.2.3 Brenda 6 (gjashtë) muajve nga pajisja me Leje Ndertimi, Koncesionari duhet te kete perfunduar se ndertuari QKT-ne e Re. Afati per QKT-ne e Re fillon te llogaritet ne momentin e miratimit te lejes se ndertimit sipas Ligjit. Ne cdo rast, Koncesionari eshte i detyruar te aplikojte sipas Ligjit per Lejen e Ndertimit brenda 80 (tetedhete) diteve nga Data Efektive.



18.2.4 Të ofrojë dhe kryejë Shërbimin e Kontrollit Teknik të Detyrueshëm të Mjeteve Rrugore me Motor dhe Rimorkiove te tyre në përputhje me Ligjet, Manualin e Kontrollit të Mjeteve, Praktikat e Industrisë së Mirë dhe Oferten e Koncesionarit dhe të mbajë të pacënuar ofrimin e këtij Shërbimi.

18.2.5 Nga Data Efektive të zbatojë si orar minimal pune ne QKT Ekzistuese, QKT e Re (pas ndërtimit në përputhje me këtë kontratë) dhe QKTL, orarin e Hënë – e Premte 09.00-17.00 dhe e shtunë 08.00-13.00. Koncesionari gjatë këtij orari detyrohet të mbajë funksionale QKT Ekzistuese, QKT e Re (pas ndërtimit në përputhje me këtë Kontratë) dhe QKTL. Ky orar mund të jetë objekt rishikimi me marrëveshje me shkrim mes Palëve mbi kërkesën e paraqitur nga pala e interesuar.

18.2.6 Të lejojë Autoritetin Kontraktues të inspektojë secilën nga QKT Ekzistuese, QKT e Re dhe QKTL në çdo kohë të arsyeshme me ose pa njoftim paraprak.

18.2.7 T'i kryejë kontrole teknike të gjitha mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove te tyre të paraqitura në testim në përputhje me Manualin e Kontrollit të Mjeteve.

18.2.8 Të mirëmbajë QKT Ekzistuese, QKT të Re dhe QKTL, Pajisjet Ekzistuese dhe Pajisjet Elektromekanike dhe Kompjuterike deri në momentin e kthimit mbrapsht tek Autoriteti Kontraktues sipas kushteve te kesaj Kontrate në përputhje me Praktikat e Industrisë së Mirë.

18.2.9 Të përballojë vetë të gjitha kostot dhe shpenzimet e çdo lloji apo natyre lidhur me largimin dhe transportin nga Sheshi të Pajisjeve Ekzistuese ne vendin e percaktuar nga Autoriteti Kontraktues në përfundim të Fazës së Ndërtimit.

18.2.10 Të ruajë të gjitha vërtetimet e papërdorura apo të palëshuara për rezultatet e kontroleve të kryera në QKT Ekzistuese, QKT e Re dhe QKTL në një vend të sigurt nën kontrollin e Koncesionarit dhe në kushte të përshtatshme për t'i ruajtur ato nga dëmtime të çdo lloji si psh. mekanike, atmosferike, etj.

18.2.11 T'i paraqesë Autoritetit Kontraktues në kohë të përshtatshme sapo t'i kërkohet prej tij informacione apo çdo dokument të kërkuar që ka të bëjë me funksionimin QKT Ekzistuese, QKT së Re dhe QKTL si dhe të Shërbimit.

18.2.12 Të shoqërojë çdo pagesë të Tarifës Koncesionare me një raport dhe dokumenta të nevojshëm plotësues mbi Xhiron e realizuar nga Tarifat e Kontrollit dhe Tarifat e Rikontrollit për periudhën për të cilën pagesa e Tarifës Koncesionare kryhet.

18.2.13 Të krijojë një bazë të dhënash elektronike të re dhe bashkëkohore dhe ta



përditësojë atë periodikisht. Specifikimet teknike për realizimin e këtij procesi do të përcaktohen nga ana e stafëve teknike përkatëse të të dy Paleve.

18.2.14 Në fund të Periudhës Koncesionare të transferojë (pa shpërblim apo pretendim tjetër monetar apo të çdo lloji) tek Autoriteti Kontraktues pronësinë mbi QKT e Re, QKTL, linjat e kontrollit dhe Pajisjet Elektromekanike dhe Kompjuterike në gjendje funksionale, përjashtuar amortizimin normal, ashtu siç do të jenë pas kryerjes së riinvestimit.

18.2.15 Të mos kryeje Sherbimin ndaj mjeteve të cilat nuk kanë paguar detyrimet fiskale që lidhen me përdorimin e mjetit të tilla si; Taksa vjetore e qarkullimit rrugor, taksa vjetore e regjistrimit të përvitshëm të mjeteve dhe gjobat për mosparaqitjen brenda afatëve për kryerjen e Sherbimit në qendrat e kontrollit teknik.

18.2.16 Brenda muajit të parë të vitit 7 (shtatë), të Periudhës Koncesionare, Koncesionari duhet të paraqesë pranë Autoritetit Kontraktor, kalendarin e punimeve të riinvestimit, ku të jenë përcaktuar afatet e riinvestimit dhe vlerat përkatëse sipas zërave.

18.3 Detyrimet e Koncesionarit para Fazës së Ndërtimit

Koncesionari merr përsipër detyrimet e mëposhtme:

18.3.1 Brenda 3 (tre) javësh nga Data Efektive Koncesionari angazhohet të lidhë Kontratën e Uzufuktit pa shpërblim, me qëllim përdorimin e QKT Ekzistuese dhe Pajisjeve Ekzistuese, këto të fundit deri në instalimin e Pajisjeve Elektromekanike dhe Kompjuterike. Koncesionari do të ndërmarrë të gjitha hapat e nevojshëm për të garantuar krijimin, vendosjen dhe regjistrimin e menjëhershëm të uzufuktit QKT Ekzistuese, si dhe do të përballojë të gjitha shpenzimet, taksat dhe kostot që lidhen me këtë uzufukt.

18.3.2 Brenda një periudhe prej 3 (tre) javësh pas Datës Efektive, Koncesionari do të dërgojë tek Autoriteti Kontraktues:

- 1) kopje autentike të Statutit, Aktit të Themelimit dhe Çertifikatën e Regjistrimit Tregtar të Shoqërisë së Projektit;
- 2) kopjet e çertifikuara të çertifikatave siguroese që vërtetojnë (në mënyrë të arsyeshme të pranueshme për Autoritetin Kontraktues) se Koncesionari është pajisur me të gjitha policat e sigurimit dhe garancitë mbuluese për t'u marrë prej tij për të gjitha qëllimet e Fazës së Ndërtimit në përputhje me Nenin 16;
- 3) të konfirmojë dhe vërtetojë në mënyrë të përshtatshme se është bërë Mbyllja Financiare.

Ndërsa:

Për projekt-zbatimin dhe identitetin e nenkontraktoreve të ndërtimit (nëse ka) së bashku me informacionin përkatës, të cilat do të jenë objekt i miratimit paraprak nga Autoriteti Kontraktues (që nuk duhet të refuzohet ose vonohet në mënyrë të paarsyeshme) para nënshkrimit afati do të jete 40 (dyzet) Dite;

18.4 Detyrimet e Posacme te Koncesionarit ne Fazen Ndertimore



18.4.1 Projekt-Ideja dhe Projekt-Zbatimi

Konçesionari do të kryejë të gjitha Punimet e Ndërtimit sipas kësaj Kontrate në përputhje të plotë me:

- i) Kërkesat Teknike të Projektimit(KTP),sipas legjislacionit per Urbanistiken
- ii) Kerkesat Teknike te Ndërtimit(KTN),sipas legjislacionit per Urbanistiken
- iii) Projekt-Idenë
- iv) Projekt-Zbatimin

Për të hequr çdo dyshim, Projekt-Zbatimi nuk duhet të vijë në kundërshtim me Projekt-Idenë dhe KTP dhe KTN.

Të gjitha rreziqet dhe kostot e Fazës Ndërtimore do të jenë mbi Konçesionarin.

18.4.2 Projektimi dhe Ndërtimi

Konçesionari, me koston dhe shpenzimet e tij, do të marrë përsipër të gjitha studimet e kërkuara nga legjislacioni në fuqi, projektet inxhinierike, oponencat teknike, prokurimin, ndërtimin dhe testet e funksionimit të Pajisjeve Elektromekanike dhe Kompjuterike në përputhje me:

- Projekt-Zbatimin;
- Grafikon e Punimeve të përcaktuar në Aneksin VIII, bashkëngjitur;
- Specifikimet teknike të hollësishme dhe të detajuara;
- Praktikën e Industrisë së Mirë; dhe
- Manualin e Kontrollit te Mjeteve.

18.4.3 Përgjegjësia e Konçesionarit

Konçesionari do të jetë i vetmi përgjegjës kundrejt Autoritetit Kontraktues për çdo të metë që ka të bëjë me studimet e kërkuara nga legjislacioni në fuqi, projektet inxhinierike, oponencat teknike, prokurimin, ndërtimin dhe testet e funksionimit të Pajisjeve Elektromekanike dhe Kompjuterike (duke përfshirë dhe Projekt-Idenë, Projekt-Zbatimin dhe Kërkesat Teknike të Ndërtimit). Moskundërshtimi nga Autoriteti Kontraktues i studimeve të kërkuara nga legjislacioni në fuqi, projekteve inxhinierike, oponencave teknike, prokurimit, ndërtimit dhe testeve të funksionimit të Pajisjeve Elektromekanike dhe Kompjuterike (përfshirë dhe Projekt-Idenë, Projekt-Zbatimin dhe Kërkesat Teknike të Ndërtimit), nuk do të interpretohet si heqje dorë e Autoritetit Kontraktues nga ndonjë e drejtë e tij sipas kësaj Kontrate dhe as do ta çlirojë në ndonjë mënyrë Konçesionarin nga ndonjë



prej detyrimeve dhe përgjegjësitë e tij të parashikuara në këtë Kontratë. Konçesionari do të jetë i vetmi përgjegjës kundrejt Autoritetit Kontraktues për aftësinë teknike, kapacitetin funksional, sigurinë e projekteve, objekteve dhe shërbimit të ofruar sipas kësaj Kontrate.

18.4.4 Raportet mbi Progresin e Ndërtimit

Gjatë Fazës së Ndërtimit Konçesionari do ta njoftojë Autoritetin Kontraktues lidhur me ecurinë e punimeve në fund të çdo muaji kalendarik.

18.4.5 Vonesat ne fazen ndertimore

Nëse, përtej kontrollit të Konçesionarit, haset ndonjë pengesë që do të rezultonte në një vonesë në kryerjen e Punimeve ose në arritjen e Datës së Përfundimit të Punimeve sipas Grafikut, Konçesionari duhet t'i dërgojë një raport Autoritetit Kontraktues brenda 5(pesë) ditëve nga data e zbulimit të pengesës, duke përshkruar arsyet që çuan ose që do të çojnë në një vonesë të tillë, si dhe masat që do të merren për të shmangur ose minimizuar vonesën për përfundimin e Punimeve të Ndërtimit sipas Grafikut të Punimeve.

Bazuar ne njoftimin e Konçesionarit, Autoriteti Kontraktues ka te drejte, por jo detyrim te zgjase fazen ndertimore, me aq kohe sa zgjat rrethana penguese.

18.4.6 Detyrime të tjera shtese

Konçesionari duhet:

- 1) të sigurojë që Autoriteti Kontraktues të ketë të drejtë të hyjë në QKT Ekzistuese dhe QKT e Re me kusht që kjo e drejtë të mos përdoret për të ndërhyrë në ndërtim ose për ndërprerjen e ndërtimit, si dhe të ushtrohet pasi t'i jetë bërë Konçesionarit një njoftim paraprak i arsyeshëm;
- 2) t'i sigurojë Përfaqësuesit të Autoritetit Kontraktues, me kërkesë të arsyeshme të këtij, kopje të çdo dokumenti, vizatimi dhe projektimi;
- 3) të parandalojë dhe/ose kontrollojë çdo ndotje mjedisore të shkaktuar nga ndonjë Punim Ndërtimi;
- 4) të marrë të gjitha masat e nevojshme të sigurisë lidhur me Sheshin;
- 5) të heqë mbetjet nga ndërtimi dhe mbeturinat e projektit në përputhje me Ligjin Shqiptar dhe Praktikën e Industrisë së Mirë;
- 6) të mos dëmtojë ndonjë tubacion, linjë kablore ose kanal ekzistues Shesh, përveç kur bëhet me aprovim nga Autoriteti Kontraktues;
- 7) të merret me të gjitha problemet ose çështjet që dalin si rezultat i Projekt-Zbatimit, projektit inxhinierik, prokurimit, ndërtimit dhe testeve të funksionimit te QKT-ve Ekzistuese, QKT e re dhe QKTL-se në mënyrën e parashikuar ose në përputhje me këtë Kontratë dhe Praktikën e Industrisë së Mirë, si dhe t'i paraqesë Autoritetit Kontraktues informacion në lidhje me këto probleme.

18.5 Detyrime të Konçesionarit pas përfundimit të Fazës Ndërtimore

18.5.1 Dërgimi i vizatimeve dhe materialeve teknike



Jo më vonë se 2 (dy) muaj pas përfundimit të Punimeve të Ndërtimit Konçesionari duhet t'i përcjellë Autoritetit Kontraktues materialet e mëposhtme:

- (i) të gjitha të dhënat teknike (duke përfshirë raportin e projektit, oponencat, dokumentet e përlogaritjeve dhe projektimit, si në formë të printuar, ashtu edhe në formë elektronike, duke përfshirë të gjitha udhëzimet e nevojshme të programit elektronik) që lidhen me këtë Konçesion;
- (ii) materialet teknike dhe vizatimet e pajisjeve, duke përfshirë skicat origjinale (përfshi vizatimet "e ndërtimit siç është realizuar"), dokumentet, udhëzimet dhe certifikatat e cilësisë, librin e evidencave të instalimeve dhe të inspektimeve; dhe
- (iii) të gjitha dokumentat ose materialet teknike që lidhen me konçesionin, siç mund të kërkohen në mënyrë të arsyeshme nga Autoriteti Kontraktues.

18.5.2 Të drejtat e Pronësisë Intelektuale

Konçesionari e garanton Autoritetin Kontraktues se ai ka pronësinë ose licencën për të përdorur Projekt-Zbatimin dhe çdo dokument tjetër të përdorur për përmbushjen e objektit të kësaj kontrate dhe që janë/mund të jenë objekt i të drejtave të pronësisë intelektuale.

18.6 Braktisja e Punimeve

18.6.1 Konçisioni do të konsiderohet i braktisur nga Konçesionari nëse, pa miratimin paraprak të Autoritetit Kontraktues, Konçesionari:

- 1) njofton Autoritetin Kontraktues për vendimin e tij për të braktisur plotësisht ose pjesërisht Punimet;
- 2) nuk rifillon plotësisht ose pjesërisht Punimet e Ndërtimit brenda tridhjetë (30) ditëve nga mbarimi i Rastit të Forcës Madhore;
- 3) ndërpret ndërtimin e të gjitha ose mbi 70 % të Punimeve të Ndërtimit për një periudhë në vazhdim prej tridhjetë (30) ditësh; ose
- 4) tërheq drejtpërdrejt ose nëpërmjet veprimit të kryer nga kontraktuesi i ndërtimit, të gjithë, ose pothuaj të gjithë, personelin nga Sheshi, para Datës së Përfundimit të Punimeve të Ndërtimit me kusht që kjo tërheqje të çojë në një ndërprerje thelbësore të Punimeve të Ndërtimit.

Data e braktisjes ose e të konsideruarit të braktisur do t'i korrespondojë:


- (i) në rastin e parashikuar në paragrafin (1) më sipër, datës së njoftimit,
- (ii) në rastet e parashikuara në paragrafet (2) dhe (3), ditës që vjen menjëherë pas datës, në të cilën kanë përfunduar afatet tridhjetë ditore të parashikuara në ato paragrafë dhe
- (iii) në rastin e parashikuar në paragrafin (4) më sipër datës kur personeli efektivisht terhiqet/largohet nga Sheshi.

18.7 Detyrimet e Konçesionarit në Periudhën e Shfrytëzimit

Shfrytëzimi dhe mirembajtja e QKT Ekzistuese, QKTL dhe pajisjeve Elektromekanike dhe Kompjuterike.

18.8. Shfrytezimi dhe mirembajtja

Që nga Data Efektive Konçesionari është i detyruar:

- 
- (i) të ushtrojë të gjitha të Drejtat Konçesionare në përputhje me Praktikën e Industrisë së Mirë;
 - (ii) t'i japë Autoritetit Kontraktues:
 - (1) një kopje të bilanceve financiare vjetore të audituara të Shoqërisë Konçesionare;
 - (2) një raport vjetor për të gjitha punimet mirëmbajtëse të planifikuara ose të paplanifikuara, si dhe
 - (3) një njoftim për çdo ngjarje të rëndësishme emergjence në lidhje me Konçesionin, veçanërisht përsa i përket shëndetit, mjedisit dhe çështjeve të sigurisë.

Raporti sipas (1) duhet të jepet jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës për vitin paraardhës dhe raporti sipas (2) duhet të jepet jo më vonë se fundi i muajit janar të vitit pasardhës për vitin paraardhës, ndërsa njoftimi sipas (3) duhet të jepet brenda 5 ditësh pas ngjarjes.

18.9 Shërbimet Publike

Konçesionari do të marrë vetë masat për furnizimin me ujë, trajtimin e ujërave të zeza dhe furnizimin me energji elektrike, si dhe do të marrë përsipër dhe do të përballojë të gjitha kostot, shpenzimet dhe detyrimet në lidhje me to.

Autoriteti Kontraktues do t'i japë Konçesionarit ndihmë të arsyeshme në lidhje me çdo marrëdhënie të tij me Entet Shtetërore përgjegjëse për sigurimin e shërbimeve publike të nevojshme në Projektin Konçesionar.

18.10 Rastet e Mospermbushjes nga Konçesionari:

Secili prej rasteve që vijon perben rastin e mospermbushjes nga Konçesionari, përveç kur kjo vjen për shkak të Rasteve të Forcës Madhore:

- (i) Konçesionari nuk ka permbushur ndonjë prej detyrimeve të tij në afatin e duhur sipas Kontrates dhe nuk ka arritur që brenda afatit përketes të korrigjimit të caktuar në këtë Kontratë për një rast specifik, ose kur nuk behet fjale për këtë rast, brenda afatit të korrigjimit të njoftuar Konçesionarit nga Autoriteti Kontraktues, të ndreqe këtë mospermbushje.
- (ii) Cdo deklaram i bere ose garanci e dhene nga Konçesionari, sipas kesaj Kontrate zbulohet te jete fals ose i pasakte.
- (iii) Konçesionari ndodhet para Rastit të Paaftesisë Paguese.
- (iv) Konçesionari nuk e njeh këtë Kontratë ose në një mënyrë ose në një mënyrë tjetër le të kuptojë qëllimin e saj për të marrë qendrë me e detyruar sipas kesaj Kontrate.

19. FORCA MADHORE



"Rast i Forcës Madhore" do të thotë çdo rrethanë që nuk është në mënyrë të arsyeshme në kontroll, të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, të Palës së Cënuar ("Pala e Cënuar") që rezulton ose shkakton pamundësi të plotë ose të pjesshme të Palës së Cënuar për të përmbushur ndonjë prej detyrimeve të saj sipas kësaj Marrëveshjeje (përveç kryerjes së pagesave të parave), por vetëm nëse dhe në masën që:

- 1) kjo rrethanë, pavarësisht ushtrimit të kujdesit të arsyeshëm, nuk mund të parandalohet ose nuk ishte e mundur të parandalohet, shmangej ose mënjanohet nga Pala e Cënuar;
- 2) Pala e Cënuar mori ose ka marrë të gjitha masat e arsyeshme paraprake, kujdesin e duhur dhe masat e arsyeshme alternative në mënyrë që të shmangte pasojën e këtij rasti në afësinë e Palës së Cënuar për të përmbushur detyrimet e saj sipas kësaj Marrëveshjeje dhe për të zbutur pasojat e saj;
- 3) ngjarja nuk është, ose nuk ka qenë pasojë e drejtpërdrejtë ose e tërthortë e shkeljes nga Pala e Cënuar të një prej detyrimeve të saj sipas kësaj Marrëveshjeje; dhe
- 4) Pala e Cënuar t'i ketë dhënë njoftim Palës tjetër ("Pala e Pacënuar").

19.2 Rastet e Forcës Madhore përfshijnë rrethanat e mëposhtme, me kusht që ato të plotësojnë kriteret e shprehura në përkufizimin e Rastit të Forcës Madhore më sipër:

- 1) veprimet e luftës, pushtimi ose akti i një armiku të jashtëm, ose aktet e terrorizmit, bllokadat, embargot, racionimet;
- 2) aktet e rebelimeve, kryengritjet, trazirat civile, grevat e natyrës politike, aktet ose fushatat e terrorizimit;
- 3) rrufeja, zjarri, tërmeti, stuhia, cikloni, tajfuni, tornado ose ndonjë fatkeqësi tjetër natyrore;
- 4) epidemia ose murtaja; dhe
- 5) çdo akt sabotimi, grevat ose veprimtaritë e punës për të imponuar ose për të ngadalësuar punën (sidoqoftë duke përjashtuar punonjësit e Palës që e pretendon atë si Rast të Forcës Madhore ose punonjësit e ndonjë prej aksionerëve të kësaj Pale, ose punonjësit e ndonjë filiali të kontrolluar, drejtpërdrejt ose tërthorazi, nga shoqëria mëmë ose degë e ndonjë aksionari të kësaj Pale).

Pala e Cënuar do të përjashtohet nga përmbushja e detyrimeve, dhe nuk do të quhet se është në mospërmbushje në lidhje Marrëveshjen e Konçesionit për aq kohë, dhe në atë masë, sa pamundësia për të përmbushur detyrimet të varet nga Ngjarja e Forcës Madhore, si dhe Afati do të shtyhet automatikisht për aq sa do të zgjasë Ngjarja e Forcës Madhore.

19.3 Pasojat e Rasteve të Forcës Madhore

Pavarësisht nga detyrimet për mirëmbajtje të Konçesionarit, siç detajohen më tej



në Nenin 2.1 ("Dhënia e të Drejtave Konçesionare"), rastet e mëposhtme do të zbatohen në masën që Konçesionari është Palë e Cënuar në një Rast të Forcës Madhore:

- 1) Rastet e Forcës Madhore të Siguruara
Në masën që Pasojat e një Rasti të Forcës Madhore janë brenda kushteve që mbulojnë nga garancitë siguruuese që kërkohet të bëhet e të mbahet sipas Nenit 16 Sigurimi, Konçesionari do të ngrëjë pretendime e bazojë ato drejtpërdrejt tek ky Nen dhe do të zbatojë procedimet përkatëse.

20. DEMSHPERBLIMI

- 20.1 Konçesionari do të jete përgjegjes për shperblimin e demit ndaj Autoritetit Kontraktues që vjen si rezultat ose pasoje e cdo Rasti Mospermbushjeje nga ana e tij, me kusht që kjo shkelje të mos jete shkaktuar në mënyrë të drejteperdrejte apo të terthorte nga një Ndryshim në Ligj.
- 20.2 Konçesionari nuk mban përgjegjesi për demet materiale të shkaktuar në mjetet rrugore me motor dhe rimorkjot e tyre që mund t'i shkaktohen paleve të treta si rezultat i ofrimit të Sherbimit nga ana e Konçesionarit në zbatim të Manualit të Kontrollit Teknik dhe Kodin Rrugor
- 20.3 Autoriteti Kontraktues do të jete përgjegjes për shperblimin e demit ndaj Konçesionarit që vjen si rezultat ose pasoje e cdo Rasti Mospermbushjeje nga ana e tij, me kusht që kjo shkelje të mos jete shkaktuar në mënyrë të drejteperdrejte apo të terthorte nga një Ndryshim në Ligj.
- 20.4 Shperblimi i Demit mund të kërkojë sipas rastit nga Konçesionari ose Autoriteti Kontraktues, pa cënuar ushtrimin e të drejtave të tjera në këto Kontrate.
- 20.5 Në të gjitha rastet pala që vendos ose pretendon të drejtën për t'iu shperblyer demit në përputhje me këto Kontrate do të ketë detyrimin të marrë të gjitha masat për të pakesuar efektet e demit të ndodhur, duke marrë parasysh se ajo mund ta bëjë këto pa shkaktuar shpenzime të paarsyeshme.

21 KONFIDENCIALITETI

- 21.1 Secila nga Palet duhet të konsiderojë si konfidenciale të gjitha dokumentet dhe informacionet e tjera në lidhje me Projektin, qofshin këto tregtare, teknike, juridike dhe nuk duhet t'ia bëjë të ditura një pale të treta, të gjithë apo një pjesë të dokumentit apo informacionit, pa miratimin e pales tjetër, përveçse për qëllimin e përmbushjes së kushteve të kësaj Kontrate.
- 21.2 Dispozita (21.1) nuk do të zbatohet në shkallen që:
 - (i) Ky informacion ka qenë në zotërim të Pales që bën zbulimin pa detyrimin e konfidencialitetit para zbulimit të tij nga zotëruesi i informacionit;

W 119731/119847
SEKRET

- (ii) Ky informacion ishte perfituar nga nje pale e trete pa detyrimin e konfidencialitetit;
- (iii) Ky informacion ka qene per perdorim publik ne kohen e zbulimit ndryshe nga shkelja e kesaj Kontrate;
- (iv) Nje informacion i tille eshte i detyrueshem per t'u nxjerre sipas ligjit;
- (v) Nje informacion i tille eshte perdorur per te zbatuar nje vendim gjyqesor ose urdher te nje organi te autorizuar publik.

21.3 Asgje ne kete Kontrate nuk do e pengoje Autoritetin Kontraktor te zbuloje Informacionin Konfidencial te Koncesionarit:

- (i) Ndaj cilitdo Enti qeveritar. Te gjitha Entet Qeveritare qe marrin kete Informacion Konfidencial do te kene te drejte t'ia japin me tej Informacionin Konfidencial departamenteve te tjera qeveritare, mbi bazen qe informacioni te jete konfidencial dhe te mos i tregohet nje pale te trete qe nuk eshte pjese e departamentit qeveritar ose e nje Autoriteti Kontraktor.
- (ii) Mbi bazen e "nevojës per njohuri" nga konsulenti, kontraktori ose ndonje person tjetër te angazhuar nga Autoriteti Kontraktor me kusht qe nje person i tille te bjere dakord qe te ruaje kete informacion si konfidencial.

22 KUFIJTE E PENALITETEVE

Kufijte e penaliteteve qe duhet te paguaje Koncesionari per moszbatim te detyrimeve ne perputhje me afatet dhe menyren e rene dakord ne kete Kontrate dhe ne Anekset e saj, do te jene ato te parashikuara ne Aneksin IX. Pagimi i cfaredolloj penaliteti nuk do te zhveshe Koncesionarin nga pergjegjesia per te ekzekutuar detyrimin apo per te paguar demin e shkaktuar ne rast se ky kalon penalitetin.

23 ZGJIDHJA E KONTRATES

23.1 Rastet e Mospërbushjes

23.1.1 Rasti i Mospërbushjes nga Koncesionari

Secili prej rasteve të mëposhtme do të përbëjë një "Rast Mospërbushjeje nga Koncesionari":

- a) mospërbushja nga Koncesionari, në një aspekt thelbësor, të kërkesave të Punimeve të Ndërtimit dhe Sherbimit (përveç rastit kur janë për t'u paguar dëmet e likujdueshme në përputhje me afatet e kësaj Kontrate);
- b) braktisja e Punimeve ose Sherbimeve nga Koncesionari;
- c) mospagimi nga Koncesionari i dëmeve të likujdueshme brenda periudhave kohore të specifikuar këtu, ose moskryerja nga



Konçesionari të ndonjë pagese tjetër për t'u paguar sipas kësaj Kontrate;

- d) është arritur Tavani i Dëmeve të Likujdueshme në Ndërtim, ose Tavani Individual i Dëmeve të Likujdueshme në Shfrytëzim dhe Mirëmbajtje ose Tavani i Përmbledhur i Dëmeve të Likujdueshme në Shfrytëzim dhe Mirëmbajtje;
- e) arritja në mënyrë të arsyeshme nga Autoriteti Kontraktues në konkluzionin se çdo informacion i rëndësishëm i dhënë nga Konçesionari në dokumentet e para-kualifikimit dhe/ose të ofertës është fals ose çorintues;
- f) Konçesionari ka qenë dënuar për ndonjë Akt Korruptues;
- g) çdo shkelje thelbësore e kësaj Kontrate, pavarësisht nëse është përcaktuar ose jo shprehimisht si e tillë këtu në këtë Kontrate.

23.1.2 Rasti i Mospërmbushjes nga Autoriteti Kontraktues

Secili prej rasteve të mëposhtme do të përbëjë një "Rast Mospërmbushjeje nga Autoriteti Kontraktues":

- a) çdo informacion i dhënë nga Autoriteti Kontraktues ka qenë fals, i pasakte dhe jo i vertete;
- b) çdo shkelje thelbësore e kësaj Kontrate, pavarësisht nëse është përcaktuar ose jo si e tillë këtu.

Procedura e Zgjidhjes së Kontrates

1 Zgjidhja e Kontrates nga Autoriteti Kontraktues

Autoriteti Kontraktues mund ta zgjidhë këtë Kontrate, duke i dhënë Konçesionarit një Njoftim për Zgjidhje në qoftë se, ka ndodhur një Rast Mospërmbushjeje nga Konçesionari që është duke vazhduar për më shumë se tridhjetë (30) ditë pas dërgimit nga Autoriteti Kontraktues të Konçesionari të njoftimit për këtë Rast Mospërmbushjeje nga Konçesionari ose ka ndodhur një Rast i Forcës Madhore, i cili vazhdon për një periudhë për më shumë se 6 (gjashtë) muaj.

2 Plani i Rregullimit

- a) Brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve pas dërgimit të njoftimit nga Autoriteti Kontraktues të Konçesionari për ekzistencën e një Rasti Mospërmbushjeje nga Konçesionari, Konçesionari mund t'i propozojë Autoritetit Kontraktues një Plan Rregullimi. Brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve pas marrjes së tij, Autoriteti Kontraktues do të shprehet nëse e pranon ose e refuzon këtë Plan Rregullimi, si dhe do të njoftojë menjëherë Konçesionarin për refuzimin ose pranimin.
- b) Nëse Autoriteti Kontraktues e refuzon Planin e Rregullimit



Konçesionari do të ketë të drejtën e një periudhe dhjetë (10) ditore për të ndrequr Rastin e Mospërmbushjes (që nga data e njoftimit për refuzimin nga Autoriteti Kontraktues), periudhë pas së cilës Autoriteti Kontraktues mund ta zgjidhë këtë Kontratë, duke i dhënë Konçesionarit Njoftim për Zgjidhje nëse Rasti përkatës i Mospërmbushjes nuk është ndrequr ende.

- c) Nëse Autoriteti Kontraktues e miraton Planin e Rregullimit, miratim i cili nuk do të refuzohet në mënyrë të paarsyeshme, Konçesionari do t'i kërkohet të zbatojë me përpikmëri këtë Plan Rregullimi. Nëse Konçesionari nuk e ka ndrequr këtë Rast Mospërmbushjeje në mbarim të periudhës kohore të përcaktuar në Planin e Rregullimit, Autoriteti Kontraktues do të ketë të drejtë t'i japë Konçesionarit Njoftim për Zgjidhje.

23.2.3 Ndreqja nga Autoriteti Kontraktues

Në rastin e një Rasti Mospërmbushjeje nga Konçesionari, Autoriteti Kontraktues do të ketë të drejtë, por nuk është i detyruar, të ndreqë ose të përpiqet të ndreqë këtë Rast Mospërmbushjeje duke:

- (i) punësuar palë të treta për të ndrequr avaritë, vonesat dhe mospërmbushjet që përbëjnë Rastin e Mospërmbushjes nga Konçesionari, ose duke e bërë vetë këtë gjë;
- (ii) i faturuar Konçesionarit të gjitha kostot dhe shpenzimet faktike dhe të justifikuara si duhet, që janë bërë në lidhje me këto ndërmarrjeje (të kryera si nga palët e treta ashtu edhe nga vetë Autoriteti Kontraktues); dhe
- (iii) tërhequr nga Garancia e Kontratës çdo shumë për t'u paguar nga Konçesionari në përputhje me nënparagrafin (ii) më sipër dhe që është ende për t'u paguar tridhjetë (30) ditë pas njoftimit të Konçesionarit nga Autoriteti Kontraktues, me anë të të cilit kërkohet pagesa e tyre (dhe, për heqjen e çdo dyshimi, Konçesionari do të jetë i detyruar t'i bëjë Autoritetit Kontraktues pas një kërkese, pagesa të drejtpërdrejta për këto shuma nëse shuma e tyre e kalon shumën e Garancisë së Kontratës).

23.2.4 Zgjidhja e Kontrates nga Konçesionari

Konçesionari mund ta zgjidhë këtë Kontratë duke i dhënë Autoritetit Kontraktues një Njoftim për Zgjidhje bazuar në një Rast Mospërmbushjeje nga Autoriteti Kontraktues, i cili nuk është kryer brenda tridhjetë (30) ditëve nga njoftimi i tij tek Autoriteti Kontraktues ose ka ndodhur një Rast i Forcës Madhore, i cili vazhdon për një periudhë për më shumë se 6 (gjashtë) muaj.

23.2.5 Pagesat e Zgjidhjes së Kontrates

(i) Në rast zgjidhjeje të kësaj Kontrate per faj te Autoritetit Kontraktues, ky i fundit detyrohet t'i paguajë Konçesionarit kompensimin sipas strukturës që vijon:


- 100% të Vlerës së Investimit te kryer por gjithmone jo me i madh se 80% e vleres se investimit të përcaktuar në nenin 8.4 më sipër plus 8% te vleres te investimit te percaktuar ne nenin 8.4 me siper në rast zgjidhjeje të Kontratës gjatë vitit të parë;
- 80% të Vlerës së Investimit te kryer, plus 8% te vleres te investimit te percaktuar ne nenin 8.4 me siper në rast zgjidhjeje të Kontratës gjatë vitit të dyte;
- 60% të Vlerës së Investimit te kryer plus 8% te vleres te investimit te percaktuar ne nenin 8.4 me siper në rast zgjidhjeje të Kontratës gjatë vitit të trete;
- 40% të Vlerës së Investimit te kryer plus 8% te vleres te investimit te percaktuar ne nenin 8.4 me siper në rast zgjidhjeje të Kontratës gjatë vitit të katert;
- 30% të Vlerës së Investimit te kryer plus 8% te vleres te investimit te percaktuar ne nenin 8.4 me siper në rast zgjidhjeje të Kontratës gjatë vitit të peste;
- 20% të Vlerës së Investimit te kryer plus 8% te vleres te investimit te percaktuar ne nenin 8.4 me siper në rast zgjidhjeje të Kontratës gjatë vitit të Gjashte;
- per vitet ne vazhdim 10% të Vlerës së Investimit te kryer plus 8% te vleres te investimit te percaktuar ne nenin 8.4 me siper në rast zgjidhjeje të Kontratës;

Te gjitha investimet e kryera deri ne momentin e zgjidhjes se kontrates, mbeten prone e Autoritetit Kontraktues.

Per efekt perlllogaritje vlere e investimit te kryer sipas ketij neni nuk mund te kaloje vleren e investimit te percaktuar ne nenin 8.4 te kontrates. Kjo dispozite nuk nenkupton se Koncesionari nuk mund te kryeje investim me vlere me te madhe se ai i percaktuar ne nenin 8.4 te kesaj Kontrate, gjate Periudhes Koncesionare.

(ii) Në rast zgjidhjeje të kësaj Kontrate per faj te Koncesionarit, ky i fundit i detyrohet Autoritetit Kontraktues kompensimin sipas strukturës që vijon:

-ne rast te zgjidhjes se kontrates ne vitin e pare,kalimin ne pronesi te Autoritetit Kontraktor te investimit total te kryer por jo me pak se 75% të Vlerës së Investimit të përcaktuar në nenin 8.4 te kesaj kontrate. Ne rast se vlere e investimit te kryer eshte me pak se 75% e Vlerës së Investimit të përcaktuar në nenin 8.4, atehere Koncesionari pervec transferimit te investimit ne pronesi te Autoritetit Kontraktues, i kompenson ketij te fundit financiarisht diferencen.



nga sa me sipër, Njoftimi i Perfundimit konsiderohet të jetë terhequr, nëse, para hyrjes së tij ne fuqi, Koncesionari vendos në pajtim me Ligjin, të:

- (i) realizojnë një peng mbi Kuotën e zakonshme dhe/ose
- (ii) të propozojnë transferimin e Projektit tek një ekip zevendes menaxherial ose një subjekt zevendes për qëllimet e sigurimit të vazhdimësisë së Projektit;

Në lidhje me sa me sipër, Autoriteti Kontraktues :

- (i) nuk mban në mënyrë të paarsyeshme ose vonon pëlqimin e tij nëse ekipi i propozuar i menaxhimit ka ekspertizën, aftësinë, reputacionin dhe gjendjen financiare të paktën si ato të Koncesionarit dhe
- (ii) kryen të gjitha veprimet që kërkohen ose janë të dobishme për të realizuar këtë transferim

23.6 Pasoja të tjera të Perfundimit

23.6.1 Me njoftimin për perfundim të parakohshëm të Kontrates, Palet janë të detyruara të nisin procedurën e dorëzimit të mjediseve dhe infrastrukurës së Projektit, në përputhje me parashikimet e nënve 3.6 dhe 3.7 të kësaj Kontrate.

23.6.2 Mbarimi i Periudhës së Koncesionit, apo perfundimi i parakohshëm i kësaj Kontrate (sidë që të ndodhë ai), nuk duhet të çojë të drejtat apo ligjshmerinë e cdonjeres prej paleve në këtë Kontratë e cila në mënyrë të qartë apo të nenkuptuar, ka si qëllim të veprave edhe pas perfundimit apo mbarimit të saj (kësaj Kontrate) mbi parashikimet e dispozitave përkatëse të kësaj kontrate.

24 SIGURIMI I KONTRATES

24.1 Koncesionari me shpenzimet e tij, i ka dorëzuar Autoritetit Sigurimin e Kontrates të leshuar nga shoqëritë e sigurimeve InterAlbanian sh.a. dhe Intersig sh.a., për një shumë të barabartë me 10 % të vlerës totale të investimit, sipas Aneksit XI të kësaj Kontrate.

24.2 Sigurimi i Kontrates do të shërbejë për të garantuar zbatimin e detyrimeve deri në perfundimin e investimit, në mënyrën dhe afatet e rena dakord në këtë Kontratë dhe/ose Aneksit e saj.

24.3 Autoriteti Kontraktor do t'i kthejë Koncesionarit Sigurimin e Kontrates pas kalimit të një periudhë prej 45 (dyzet e pesë) ditësh nga dita e perfundimit të Periudhës Koncesionare. Përsa do të jetë i vlefshëm sigurimi i Kontrates, penalitetet që do të zbatohen për mospermbushje të detyrimeve nga ana e Koncesionarit do të mbahen nga shumën e sigurimit të kontrates.

Pa cenuar asnjë të drejtë tjetër, Palet kanë të drejtë në çdo kohë të kompensojnë njëra tjetrën për detyrimet monetare të ndërsjellta ndërmjet tyre.

24.4 Në rast se zgjidhja rezulton nga një Mospermbushje e Koncesionarit siç parashikohet në këtë Kontratë, Autoriteti Kontraktues ka të drejtë të marrë nga Garancia e Kontratës deri në atë shumë sa të mbulojë dëmet, pa i cenuar të drejtën Autoritetit Kontraktues për të kërkuar zhdëmtimin e dëmeve përtej shumave të marra nga Garancia e Kontratës.



25. TRANSFERIMI I KONTRATES

- 25.1 Palet bien dakord se kjo Kontratë do t'i caktohet nga Koncesionari, Shoqërisë Koncesionare në përputhje me dispozitat e kësaj Kontrate. Për këtë qëllim, mbi bazën e rregjistrimit të Shoqërisë Koncesionare në Rregjistrin Tregtar që mbahet nga Qendra Kombëtare e Rregjistrimit, Koncesionari do të njoftojë me shkrim në formë të shkruar Autoritetin Kontraktues.
- 25.2 Në lidhje me një gjë të tillë, Palet bien dakord se të gjitha të drejtat dhe /ose detyrimet e lidhura me këtë Kontratë do të transferohen nga Koncesionari tek Shoqëria Koncesionare duke filluar që nga data e rregjistrimit të Shoqërisë Koncesionare në Qendrën Kombëtare të Rregjistrimit. Me zgjidhjen ose mbarimin e Kontrates, pas dorezimit të QKT dhe aseteve të tjera në shërbim të Projektit, të drejtat që mbeten si emri tregtar etj i transferohen Koncesionarit.
- 25.3 Përveç rastit të mesipër, Koncesionari dhe Shoqëria Koncesionare nuk kanë të drejtë të transferojnë pjesërisht apo tërësisht të drejtat dhe detyrimet e marra për sipër në këtë Kontratë, përveç se një transferim i tillë miratohet nga Autoriteti Kontraktues.
- 25.4 Koncesionari në cilësinë e ortakut të vetëm të Shoqërisë Koncesionare nuk do të ketë të drejtë të lërë peng, rëndojë me barrë në çdo mënyrë tjetër, shesë apo transferojë në çdo mënyrë pjesët/aksionet e Shoqërisë Koncesionare që do të themelojë, pa miratimin paraprak të Autoritetit Kontraktues dhe në çdo rast jo para përfundimit të Fazës Ndërtimore dhe vënies në funksion të QKT Ekzistuese, QKT së Re dhe QKTL për ofrimin e Shërbimit të Kontrollit Teknik të Detyrueshëm të Mjeteve Rrugore me Motor dhe Rimorkiove. Një miratim dhënë nga Autoriteti Kontraktues para përfundimit të Fazës Ndërtimore, në kundërshtim me këtë dispozitë do të jetë i pavlefshëm.

26. MARREVESHJA E PALEVE

- 26.1 Asgjë në këtë Kontratë nuk ka për qëllim që të krijojë një ortakëri apo një marrëdhënie ligjore të cfarëdo lloji që mund të shtonte përgjegjësi mbi njerën Pale për veprimin apo mosveprimin e Pales tjetër apo që të autorizonte secilin nga Palet që të veprojë si agjente për Palen tjetër. Asnjëra nga Palet nuk do të ketë Autoritetin që të bëjë përfaqësime apo të veprojë në emër të Pales tjetër apo të angazhojë Palen tjetër në cfarëdo mënyrë.
- 26.2. Nëse cilado nga dispozitat/nenet e kësaj Kontrate vlerësohet si e pavlefshme, e paligjshme apo e pazbatueshme për cfarëdo arsye dhe nga cilado gjykatë apo juridiksion kompetent, një dispozitë/nen i tillë do të shfuqizohet pa sjellur pasoja për dispozitat që mbeten. Nëse një dispozitë/nen i kësaj Kontrate që është themelore për përmbushjen e qëllimit të kësaj Kontrate gjykohet se është e pavlefshme në cfarëdo shtrirje, Koncesionari dhe Autoriteti do të fillojnë menjëherë negociatat në mirëbesim për ta rregulluar këtë pavlefshmeri.

27. NDRYSHIMET E KONTRATES

Kjo Kontratë mund të ndryshohet me marrëveshje të shkruar të të dy Paleve. Secila Pale mund t'i drejtojë një kërkesë për ndryshim Pales tjetër në çdo kohë gjatë Periudhës Koncesionare. Kërkesa duhet të jetë me shkrim, e justifikuar dhe të përmbajë

fakte dhe rrethana konkrete për arsyet e ndryshimit.

Brenda 30 ditëve nga paraqitja e kërkesës pala tjetër duhet të shprehet në mënyrë të shkruar në lidhje me pranimin ose refuzimin e ndryshimeve. Afati 30 ditor përfshin të gjithë negociimin e çështjes.

Cdo ndryshim i kësaj Kontrate apo Aneksëve bashkëlidhur, do të jetë pjesë përbërëse dhe e pandashme e kësaj Kontrate.

28 GJUHA E KONTRATES

Kjo Kontrate do të hartohet në 4 (kater) kopje origjinale secila në gjuhën shqipe dhe angleze dhe të gjitha komunikimet dhe njoftimet ndërmjet Paleve në lidhje me të do të jenë në gjuhën shqipe. Versioni në gjuhën shqipe mbizoteron në çdo rast. Shpenzimet në lidhje me çdo përkthim të mundshëm merren persiper nga Koncesionari.

29 FOSILET DHE OBJEKTET ANTIKE

Në zbatim të Nenit 3.3.4, Koncesionari do të njoftojë menjëherë Autoritetin në rast të zbulimit të fosileve apo objekteve antike. Pas marrjes së njoftimit nga Koncesionari, Autoriteti Kontraktues do të informojë Autoritetet kompetente Shqiptare, të bashkërendojnë kerkimet e fosileve ose objekteve antike në sheshin e ndërtimit.

30 PAJISJET E FURNIZIMI DHE GARANCITË E PUNIMEVE

30.1 Koncesionari garanton se të gjitha pajisjet e përdorura ose të përfshira në Punimet e Ndërtimit do të jenë të reja dhe të papërdorura dhe në përputhje me të gjitha dispozitat e zbatueshme të Ligjit shqiptar apo Ligjin përkatës të huaj, duke përfshirë Ligjin për Mjedisin, si kriteret e standardet e zbatueshme përgjithësisht në fushën e ndërtimit.

30.2 Pa rënë ndesh me ndonjë garanci tjetër sipas Ligjit shqiptar, Punimet e parashikuara sipas kësaj Marrëveshjeje do të mbulohen me një garanci 10 (dhjetë) vjeçare nga Koncesionari për punimet civile kundër defekteve të fshehta që nga Data e Përfundimit të Punimeve të Ndërtimit, si dhe gjithashtu me një detyrim 2 (dy) vjeçar të Koncesionarit për të ndrequr çdo defekt të fshehur ose të dukshëm ose çdo papajtueshmëri me parashikimet e Kësaj Kontratë duke filluar gjithashtu që nga Data e Përfundimit të Punimeve të Ndërtimit.

31 NJOFTIMET

31.1 Cilatdo njoftime, të dhëna sipas apo në lidhje me këtë Kontratë do të jenë me shkrim, të nënshkruara nga apo në emër të Paleve që e bëjnë njoftimin dhe do të njoftohen përmes dërgimit personalisht apo dërgimit me postë rekomandë, në adresën e deklaruar nga Pala në këtë Kontratë. Njoftimet nuk do të dërgohen me postë elektronike (e-mail).

31.2 Cdo kërkesë për ndryshim do të jetë me shkrim dhe e nënshkruar.

31.3 Do të quhet se një njoftim është marrë:

- (i) nëse është dërguar personalisht, konsiderohet e dorëzuar të nesërmen e dorëzimit;
- (ii) nëse është dërguar me postë rekomandë, konsiderohet e dorëzuar me marrjen.



lajmerimit te marrjes

Adresat për njoftime dhe komunikime sipas kësaj Kontrate janë:

Autoriteti Kontraktues:

Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacioneve

Sheshi Skenderbej, Nr. 5

Tirana, Albania

Attn: Shkëlqesisë së Tij, Ministrit

Konçesionari;

SGS Albania

(Adresa e shoqërisë do të njoftohet nga Shoqëria Konçesionare pas themelimit të saj sipas kësaj kontrate)

32 LIGJI I ZBATUESHEM DHE ZGJIDHJA E MOSMARREVESHJEVE

- 32.1 Kjo Kontrate do të rregullohet dhe interpretohet në përputhje me ligjet e R.SH-se.
- 32.2 Cdo kundërshti, mosmarreveshje apo ankese mes palëve kontraktuese që lind ose ka lidhje me zbatimin dhe interpretimin e kësaj Kontrate Konçesionare, duke përfshirë, por jo vetëm, çështjet që kanë të bëjnë me përfundimin e saj, shkëlqet, zgjidhjen, përfshirë ose efektet para dhe pas kontraktore, qofshin keto të përfshirë në këto Kontrate apo instrumente të tjera ligjore do të kalohet nga Palet e përfshirë në këto Mosmarreveshje fillimisht tek zgjidhja me anë të marreveshjes me mirëkuptim, duke përdorur procesin e shkallëzimit sipas Aneksit X, bazuar në vullnetin e mirë.
- 32.3 Vendimi i Perbashket dhe unanim i Autoritetit dhe Konçesionarit, apo përfaqësuesve të tyre do të jetë një vendim përfundimtar dhe i detyrueshem për Palet.
- 32.4 Pala që dëshiron të fillojë Procesin e Shkallëzimit do t'i dërgojë një njoftim me shkrim palës tjetër. Nëse përfaqësuesi i Autoritetit Kontraktor dhe përfaqësuesi i Konçesionarit nuk takohen, ose, Mosmarreveshja nuk zgjidhet brenda 1 muaji nga marrja e këtij njoftimi, cdo palë e Mosmarreveshjes mund të kërkojë që Mosmarreveshja të zgjidhet në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tirane sipas legjislacionit shqiptar në fuqi. Kjo dispozitë në asnjë rast nuk përbën kufizim apo heqje dorë të Konçesionarit nga e drejta e tij e parashikuar në Nenin 33 më poshtë si dhe nuk ka përparësi ndaj Nenit 33 për sa parashikohet në të.

33 MBROJTJA E INVESTITORIT TE HUAJ


Në rast se mosmarreveshja lind ose ka lidhje me shpronësimin, kompensimin për shpronësimin ose diskriminimin, si dhe transferimet sipas nenit 7 të ligjit nr.7764, dt.2.11.1993 "Për Investimet e Huaja", Investitori i Huaj (Konçesionari) mund t'i drejtohet edhe Qendres Nderkombetare për Zgjidhjen e Mosmarreveshjeve të Investimeve (ICSID) për zgjidhjen e asaj mosmarreveshje me Shtetin Shqiptar (R.SH-se).



MINISTRIA E PUNEVE PUBLIKE, TRANSPORTIT DHI TELEKOMUNIKACIONIT

Emri: Luçiano

Funksioni: Minister



SOCIÉTÉ GÉNÉRALE DE SURVEILLANCE SA

Emri: Jacques Vollemer

Funksioni: Vice President